# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5676
E martë, 15 janar 2019
çmimi 0.40 €


## Rama do ta ushtrojë edhe postin e ministrit të Jashtëm



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

EKIPI NEGOCIATOR I KOSOVËS NË DIALOGUN ME SERBINË KA MBAJTUR TAKIMIN E RADHËS ME LIDERËT SHTETËRORË FAQE 4-5

# Ekipi negociator: Kosova s'do të bëjë kompromise të rënda në Bruksel



Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës dhe anëtarët e ekipit negociator për dialog me Serbinë kanë siguruar qytetarët e Kosovës se në këtë proces nuk do të gabojnë në Bruksel. Kryeparlamentari Kadri Veseli dhe bashkëkryesuesi i delegacionit, Shpend Ahmeti, kanë deklaruar se do ta respektojnë Kushtetutën e Kosovës dhe nuk do të bëjnë kompromise të rënda në Bruksel. Sipas tyre, një transparencë e thellë do ta përcjellë këtë proces deri në fund. Në këtë takim të ardhës krerët e institucioneve janë njoftuar edhe me vendimin për krijimin e gjashtë komisioneve për tema që priten të ngrehën në dialog

## Tahiri: Kodi i ri penal rrit efikasitetin në luftimin e krimit dhe korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se me kodin e ri të procedurës penale do të rritet efikasiteti në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Të hënën në një konferencë me gazetarë ai ka thënë se përmes ndryshimeve që janë bërë në këtë kod do të mundësohet gjykimi në mungesë për të gjitha rastet, duke përfshirë edhe ato të krimeve të luftës



FAQE 3



## Jasharaj: Greva do të zgjasë deri të realizohen kërkesat e mësimdhënësve

FAQE 6

### AKTUALE



**MË MIRË GJENERAL ME KOKË TË NGRËNË SE ROB ME BIOGRAFI TË PASTËR** F. 11

Shkruan: Ismail SYLA

**E KUJT ËSHTË QEVERISJA: PERSONALE E RAMËS APO E SOCIALISTËVE?** F. 11



Nga Bedri ISLAMI

**MBI 16 MIJË NËNSHKRIME NË PETICIONIN PËR BASHKIMIN E MITROVICËS** F. 5

**VAZHDON PAQARTËSIA SHTETËRORE NDAJ DORËHEQJEVE TË NË VERI** F. 7

### EKONOMI

**HARADINAJ: ME GJITHË SFIDAT QË DO TË DALIN, FOKUSIN DO TA KEMI NË EKONOMI** F. 9

**ZVICRA PËRKRAH PROMOVIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE TË KOSOVËS NË TREGUN ZVICERAN** F. 9

### KULTURË

**TIVARI NË VARGJE, TEMA E MADHE E KUJTESËS KOLEKTIVE SHQIPTARE** F. 12

Prof. dr. Begzad BALIU

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Nis intervistimi i disa ish-pjesëtarëve të UÇK-së në Hagë

HAGË, 14 JANAR - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Rrustem Mustafa, u paraqit të hënën për intervistim në Prokurorinë Speciale në Hagë, në lidhje me pretendimet për përfshirjen e ish-pjesëtarëve të UÇK-së në krime të luftës dhe të pasluftës në Kosovë. Në një deklaratë të shkurtër për gazetarë, para intervistës, Mustafa ka thënë se "do t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve të prokurorit".

Në Hagë këtë javë do të intervistohet edhe Sami Lushtaku, po ashtu ish-komandant i UÇK-së. Në mesin e të ftuarve për intervistim janë edhe Sokol Dobruna, Nazif Mehmeti dhe Raimonda Rreci.

Avokatët e disa të të ftuarve kanë thënë se klientët e tyre "do të paraqiten vullnetarisht" dhe se "janë të gatshëm të sqarojnë çdo rrethanë" që po heton Prokuroria Speciale. Është raportuar se Remzi Shala, i cili po ashtu ka marrë ftesë, nuk do të paraqitet në intervistë, pasi ka thënë se nuk i beson Gjykatës Speciale që do t'i trajtojë pretendimet për krime lufte në Kosovë.

Në zyrën e Prokurorit Special nuk kanë folur rreth ftesave, ndërsa autoritetet në Kosovë u kanë bërë thirrje të gjithë atyre që janë ftuar për intervistë, të përgjigjen, në mënyrë që ta tregojnë "luftën e pastër të UÇK-së".



# OVLUÇK-ja kundërshton marrjen në biseda informative të luftëtarëve të UÇK-së me status të padefinuar

PRISHTINË, 14 JANAR (ER) - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka kundërshtuar marrjen në biseda informative të ish-luftëtarëve të UÇK-së me status të padefinuar nga ana e Gjykatës Speciale. Kjo organizatë nëpërmjet një reagimi publik ka theksuar se bisedat informative kanë qenë praktikë e ish-sistemit jugosllav. "Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës vazhdimisht ka kundërshtuar krijimin e Gjykatës Speciale përmes së cilës do të gjykohen luftëtarët e UÇK-së, duke e konsideruar si një gjykatë



diskriminuese që gjykon vetëm shqiptarët, por jo edhe kriminelët serbë që kryen krime në Kosovë. Krijimi i kësaj gjykate, fatkeqësisht, është votuar nga ana e Kuvendit të Kosovës, e cila do të funksionojë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe, përkundër kritikave tona, të ftuarit duhet të përgjigjen dhe gjatë proceseve gjyqësore ta vërtetojnë pafajësinë e tyre. OVLUÇK kundërshton marrjen në biseda informative të luftëtarëve të UÇK-së me status të padefinuar nga ana e Prokurorisë Speciale, e cila ka për qëllim që nga këto biseda informative të sigurojë prova e që pastaj t'i akuzojë luftëtarët e UÇK-së", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

OVLUÇK-ja ka vlerësuar se bisedat informative kanë qenë praktikë e ish-sistemit jugosllav i cili në të kaluarën i ka përdorur ato për të ngritur akuza dhe ka organizuar me qindra gjyqe nga të cilat u dënuan me mijëra intelektualë dhe të rinj e të reja shqiptarë. "Duke pasur parasysh këtë përvojë të hidhur nga e kaluara, e cila, fatkeqësisht, po përsëritet edhe tani, Organizata e Veteranëve të UÇK-së u bënë thirrje të gjithë të ftuarve nga Gjykata Speciale të mos pranojnë të bashkëpunojnë me Prokurorinë Speciale, pra të mos japin deklarata pranë saj, e cila nuk ka prova, por përmes këtyre bisedave informative po synon t'i nxjerrë ato e për t'i dënuar luftëtarët e UÇK-së", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

# Rama do ta ushtrojë edhe postin e ministrit të Jashtëm

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka konfirmuar të hënën se ai vetë do ta ushtrojë detyrën e shefit të diplomacisë së vendit në mungesë të një ministri të Jashtëm

TIRANË, 14 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije të hënën se ai vetë do ta ushtrojë detyrën e shefit të diplomacisë së vendit në mungesë të një ministri të Jashtëm. Ai përmes një postimi në rrjetin social "Twitter" ka bërë me dije marrjen e përgjegjësisë së ministrit të Jashtëm, duke kritikuar presidentin Ilir Meta. "Presidenti e ka çdekretuar ministrin e Jashtëm në afatin kushtetues. Shkelje e radhës që do ta ballafaqojmë bashkë me të tjerat në Gjykatën e re Kushtetuese. Deri atë ditë që vjen shumë shpejt, do të jem de jure në këtë rol sepse s'kemi kohë për të humbur në kërkim të presidentit", ka shkruar Rama.

Presidenti Meta ditë më parë ka refuzuar ta dekretojë ministrin e emëruar Gent Cakaj. Ai nëpërmjet një letre drejtuar kryeministrit ka pohuar se "profili i zotit Genti Cakaj, i propozuar për postin e ministrit për Evropën




dhe Punët e Jashtme, ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative, shtetërore, në secilin element dhe në tërësi".

Vendimi i kryeministrit shqiptar u mor pas mbledhjes së kryesisë së Partisë Socialiste, ku u diskutuan hapat e ardhshëm për ta zgjidhur ngërçin Qeveri-President. PS-ja do ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila do të shprehet vetëm kur të mund të bëhet funksionale, çështje që do të marrë kohë.

Gjykata Kushtetuese në Shqipëri është jashtë funksionit dhe e mbyllur përkohësisht pasi nga nëntë anëtarët e saj, tre janë dorëhequr ose kanë mbaruar mandatet, katër janë rrëzuar në procesin e vetingut dhe vetëm dy kanë mbijetuar.

Modeli i kryeministrit që të ushtrojë edhe detyrën e ministrit të Jashtëm është bërë edhe në Greqi, ku kryeministri grek Alexis Tsipras, pas largimit të Nikoz Kotzias si ministër i Jashtëm, mori përsipër edhe këtë post.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka prezantuar ndryshimet në Kodin e ri të Procedurës Penale

# Tahiri: Kodi i ri penal rritë efikasitetin në luftimin e krimit dhe korrupsionit



Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se me kodin e ri të procedurës penale do të rritet efikasiteti në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Të hënën në një konferencë me gazetarë ai ka thënë se nëpërmjet ndryshimeve që janë bërë në këtë kod do të mundësohet gjykimi në mungesë për të gjitha rastet, duke përfshirë edhe ato të krimeve të luftës. Sipas ministrit Tahiri, me ndryshimet e bëra askush nuk do të mund t'i ikë ballafaqimit me drejtësinë

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 JANAR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, të hënën ka prezantuar para medieve ndryshimet që janë bërë në kodin e ri të procedurës penale i cili do të shqyrtohet të martën në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës. Ministri ka bërë me dije se kodi i ri i procedurës penale do ta rritë efikasitetin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Nga 547 nene që ka Kodi, 220 prej tyre janë shqyrtuar dhe janë harmonizuar me parimet më të larta të një sistemi ligjor efikas dhe të drejtë, duke u fokusuar në ndryshime që do të mundësojnë luftim të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Pra, me kodin e ri të procedurës penale po rrisim efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit pavarësisht se kush është i akuzuar", ka deklaruar Tahiri, duke shtuar se ndër ndryshimet thelbësore është suspendimi i zyrtarëve të lartë publikë për të cilët është shpallur aktgjykim dënues lidhur me veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsionit. "Qëllimi i këtij ndryshim-propozimi është që përmes suspendimit të këtyre zyrtarëve të parandalohet keqpërdorimi i mëtejshëm i autoritetit dhe mos t'u lihet mundësia të ndikojnë në prova, element ky kyç për të siguruar ndjekje penale të suksesshme. Nenet e propozuara vlejnë për të gjithë personat zyrtarë të akuzuar për veprat penale të korrupsionit, duke mundësuar kështu trajtimin dhe qasjen uniforme ndaj tyre pa marrë parasysh funksionin ose detyrat që mund t'i ushtrojnë", është shprehur Tahiri. Sipas ministrit, me ndryshimet e bëra askush nuk do të mund t'i ikë ballafaqimit me drejtësinë.

Në kuadër të ndryshimeve që janë bërë, ministri Tahiri ka përmendur heqjen e dëgjimit të dytë, alternativën e zgjatjes së afatit të hetimeve, ndryshimet që lidhen me procedurat e konfiskimit të pasurisë së paluajtshme të fituar në mënyrë të paligjshme e deri te shtimi i gjykimit në mungesë, propozim ky që, sipas Tahirit, ka ardhur për shkak se në shumë raste kur ka pasur vështirësi për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, të pandehurit i janë shmangur drejtësisë, e sidomos për krimet më të rënda siç janë krimet e luftës.

Përveç kësaj, ai ka thënë se mungesa e të pandehurit në gjykim ka shkaktuar edhe shpenzime të mëdha si dhe ka rezultuar pa një vendim final nga ana e gjykatës. "E them me përgjegjësi se me ndryshimet e bëra askush nuk do të mund t'i ikë ballafaqimit me drejtësinë, askush nuk do të mund të llogarisë në pasuri të fituar me vepër penale dhe askush nuk do të mund ta sfidojë sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës. Jam i bindur se ky kod do të ketë përkrahje të gjerë edhe në Qeveri edhe në Kuvend dhe puna e mirë që është bërë në hartimin e tij, të përmbyllet sa më parë me miratim, duke mundësuar kështu transformimin e drejtësisë penale në Republikën e Kosovës si një sistem efikas, të drejtë, llogaridhënës dhe të përgjegjshëm", ka theksuar ministri Tahiri.

## Shpenzimet do t'u hiqen vetëm të akuzuarve nga Gjykata Speciale

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka treguar se deri më tani asnjë person nuk ka kërkuar asistencë financiare për mbrojtje juridike nga Gjykata Speciale në Hagë pasi që një asistencë e tillë do t'u ofrohet vetëm personave ndaj të cilëve do të ngrihet aktakuzë. "Ligji për mbrojtjen juridike të personave të akuzuar nga Dhomat e Specializuara ka tre komponentë. E para është asistenca financiare për mbrojtje juridike të personave të akuzuar. E dyta është asistenca financiare të familjarëve të tyre që do t'i vizitojnë në qendrat e paraburgimit dhe e treta do të jetë kompensimi financiar në rast se lirohen të pafajshëm nga ky proces", ka thënë Tahiri, duke shtuar se shumë shpejt në Qeveri do të dërgohen disa akte nënligjore nëpërmjet të cilëve do të përcaktohet shuma që do të paguajë shteti për mbrojtjen e personave të akuzuar nga Gjykata Speciale. Tahiri është zotuar se procesi i financimit të mbrojtjes për të akuzuarit potencialë nga Gjykata Speciale do të jetë transparent. "Do të jemi maksimalisht transparentë për shpenzimin e parasë publike për mbrojtjen sepse është obligim i shtetit të Kosovës dhe është obligim edhe transparenca maksimale karshi qytetarëve. Do të ketë një përcaktim të asaj se deri në çfarë shume do të paguhet nga shteti i Kosovës për avokatë për këta persona", ka deklaruar Tahiri.

Të hënën në Hagë për herë të parë Gjykata Speciale ka intervistuar ish-komandantin e Zonës Operative të Llapit, Rrustem Mustafa.

Ekipi negociator i Kosovës në dialogun me Serbinë ka mbajtur takimin e radhës me liderët shtetërorë

# Ekipi negociator: Kosova s'do të bëjë



Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës dhe anëtarët e ekipit negociator për dialog me Serbinë kanë siguruar qytetarët e Kosovës se në këtë proces nuk do të gabojnë në Bruksel. Kryeparlamentari Kadri Veseli dhe bashkëkryesuesi i delegacionit, Shpend Ahmeti, kanë deklaruar se do ta respektojnë Kushtetutën e Kosovës dhe nuk do të bëjnë kompromise të rënda në Bruksel. Sipas tyre, një transparencë e thellë do ta përcjellë këtë proces deri në fund. Në këtë takim të radhës krerët e institucioneve janë njoftuar edhe me vendimin për krijimin e gjashtë komisioneve për tema që priten të ngrehën në dialog

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 JANAR - Me ftesë të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, të hënën në mjediset e Kuvendit janë takuar ekipi shtetëror në dialogun me Serbinë dhe drejtues të institucioneve të Kosovës: kryeparlamentari Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe përfaqësues të Zyrës së Presidentit. Përkundër ftesës, në takim nuk ishin të pranishëm përfaqësuesit e LDK-së dhe të Lëvizjes Vetëvendosje. Krerët institucionalë dhe ekipi negociator i Kosovës për bisedimet me Serbinë janë zotuar për transparencë në këtë proces. Pas këtij takimi ata kanë bërë me dije se në Bruksel Kosova nuk do të gabojë dhe nuk do të bëjë kompromise të rënda.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se ky takim vjen në kuadër të komunikimit dhe koordinimit lidhur me dialogun me Serbinë dhe vetëm disa ditë pas takimit që ekipi shtetëror ka realizuar me përfaqësues të BE-së në Bruksel, por edhe në kuadër të zotimit për transparencë dhe llogaridhënie para qytetarëve dhe institucioneve. Veseli ka theksuar se takimet e tilla duhet të shërbejnë si forume të hapura diskutimi midis drejtuesve të institucioneve kryesore të vendit dhe delegacionit shtetëror. Duke e konsideruar të shkëlqyeshme punën e deritashme të delegacionit shtetëror, kreu i Kuvendit ka thënë se duhet të jetë e qartë se ka vetëm një vendimmarrje: Kosova e pavarur dhe sovrane, e pacenuar territorialisht, njohje nga Serbia dhe ulëse në OKB. "Do të ketë marrëveshje në interes të Kosovës. Pothuajse çdo ditë jemi duke marrë letra dhe nga takimet po marrim qëndrime shumë zyrtare të ShBA-së dhe të BE-së për procesin e dialogut. Është mirë të merren përgjegjësi e të mos mendohet vetëm për ego politike e rehabilitime, në çaste shumë vendimtare për vendin. Vendimmarrja do të jetë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është Kuvendi i Kosovës dhe çdo vendimmarrje e cila do të bëhet për Kosovën do të jetë me 2/3 e Kuvendit. Po ashtu, është referendumi ku do të vendosin vetë qytetarët tanë", ka thënë Veseli. Ai ka ftuar edhe pjesën tjetër të opozitës që t'i marrë përgjegjësitë që i takojnë në këtë proces. "Do të ketë marrëveshje në inertes të Kosovës. Ju e dini se çdo ditë jemi duke marrë letra dhe nga takimet po marrim qëndrime shumë zyrtare të Amerikës dhe të BE-së për procesin e dialogun. LDK-ja, siç duket, në mënyrë të veçantë po e di se nuk është rendi i zgjedhjeve. Sa më shumë po flasin rreth procesit të dialogut ata po shtojnë procesin zgjedhor për të përfituar politikisht. Është mirë për të marrë përgjegjësi dhe të mos mendohet në çastet vendimtare vetëm për egot politike dhe rehabilitimet e tyre", ka thënë Veseli, duke i drejtuar një ftesë LDK-së. "E kam një ftesë për LDK-në: mos t'i fërkojë duart, se mbaroi që 20 vjet. Nuk do të na gjejë asgjë, as në Gjykatën Speciale dhe nuk e kemi ndërmend të gabojmë. Kot po i fërkoni duart", është shprehur Veseli.

Kurse bashkëkryesuesi i delegacionit, Shpend Ahmeti, ka thënë se në takimin e 8 janarit në Bruksel është bërë e qartë se nuk do të ketë marrëveshje nëse nuk diskutohet për njohjen e ndërsjellë. Ai paralajmëroi se më nuk do të ketë dialog teknik. "Është e qartë që pas takimit në Bruksel ne i kemi disa objektiva më të qarta. E para është se më nuk ka dialog teknik dhe është e qartë se ky dialog rezulton me njohje të ndërsjellë. Nëse nuk ka njohje e as perspektivë për anëtarësim në OKB, nuk do të ketë asnjë marrëveshje tjetër", ka thënë Ahmeti. Ai ka bërë me dije se krerët e institucioneve janë njoftuar edhe me vendimin për krijimin e gjashtë komisioneve për tema që priten të ngrehën në dialog. Ai ka bërë me dije se Kosova për asnjë çmim nuk do të bëjë kompromise të rënda në këtë proces. "Është e qartë se do të kemi një dialog intensiv, është e qartë se po përpiqemi ta përdorim këtë dritare të hapur që ta arrijmë një marrëveshje me Serbinë. Por, po ashtu, është e qartë se kjo nuk do të thotë gatishmëri e jona për kompromise të rënda. Ne e kemi Kushtetutën e Kosovës dhe i kemi qëndrimet tona", ka thënë Ahmeti. Ai ka folur edhe për temat që pritet të diskutohen në të ardhmen në Bruksel. "I njoftuam krerët shtetërorë për temat e hapur të cilat priten të diskutohen, përfshirë këtu të zhdukurit, të zhvendosurit, trashëgiminë kulturore, pronat, çështjet ekonomike apo drejtësinë tranzicionale", ka treguar Ahmeti.

Ndërkaq zëvendëskryeministri, njëherësh bashkëkryesues i delegacionit, Fatmir Limaj, ka thënë se në këtë takim Kosova ka shprehur përkushtimin e qartë për dialog, duke shtuar se Kosova është e interesuar të arrijë një marrëveshje gjithëpërfshirëse e cila në vete ngërthen njohje reciproke mes dy vendeve, anëtarësim të Kosovës në OKB, njohje nga pesë vendet e BE-së si dhe hapjen e perspektivës së qartë

# kompromise të rënda në Bruksel



evropiane për Kosovën. "Ka qenë një takim i mirë, i frytshëm dhe përshtypjet tona janë të mira. Delegacioni shtetëror i Kosovës do të bëjë maksimumin që të ketë bashkërendim të plotë me institucionet e tjera kushtetuese në vend", ka thënë Limaj, duke shtuar se pas çdo takimi në Bruksel do të njoftohen krerët e institucioneve në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës për këto takime.
Presidenti Hashim Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" i ka dhënë mbështetje ekipit negociues. Ai ka thënë se Kosova me vështirësi po e ndërton unitetin e domosdoshëm në çështjet e interesit shtetëror. "Nëse do të jemi të bashkuar, ne do ta përmbyllim me sukses edhe këtë kapitull të shtetndërtimit", ka thënë Thaçi. Ai ka thënë se askush nuk duhet të hezitojë që të marrë përgjegjësi në këtë fazë përfundimtare të dialogut i cili pritet të përfundojë me një marrëveshje paqësore dhe gjithëpërfshirëse që Kosovës do t'ia sigurojë njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në OKB, NATO dhe BE.
Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka reaguar të hënën ndaj ftesës për t'u bërë pjesë e dialogut. Mustafa në një konferencë për medie ka thënë se LDK-ja nuk sheh asnjë arsye që t'i bashkohet ekipit negociator. "Ne nuk shohim asnjë arsye që të bëhemi pjesë dekoruese e ekipit negociator. Qëndrimi i LDK-së ka qenë dhe mbetet se dialogun duhet ta zhvillojë Qeveria dhe përgjegjësinë për procesin e dialogut duhet ta marrë një qeveri legjitime", është shprehur Mustafa.

# Mbi 16 mijë nënshkrime në peticionin për bashkimin e Mitrovicës

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

MITROVICË, 14 JANAR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, në prani të drejtorëve komunalë, të hënën ka mbajtur konferencën e thirrur për media në lidhje me peticionin e iniciuar për bashkimin e qytetit të Mitrovicës. Qëllimi i kësaj konference ishte që të njoftohen qytetarët dhe institucionet më shumë me veprimet që janë ndërmarrë dhe me organizimin e nënshkrimit të peticionit për ndryshim- plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave.
Në fjalën e tij kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se peticioni për bashkimin e Mitrovicës për vetëm shtatë ditë ka arritur të mbledhë rreth 16 594 nënshkrime të qytetarëve nga të gjitha nacionalitetet, me të cilin nga Kuvendi i Kosovës kërkojnë që të njëjtin ta procedojë tutje për miratim, me qëllim të bashkimit të Komunës së Mitrovicës, por duke mos cenuar në asnjë mënyrë integritetin territorial të Republikës së Kosovës. "Siç është thënë edhe më parë, meqenëse në veri të Mitrovicës është krijuar një realitet i ri, si dhe fakti që nga pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës janë të zhvendosur mbi 15 000 shqiptarë, pjesa dërrmuese e të cilëve edhe sot e kësaj dite nuk kanë mundur të



kthehen në pronat e tyre, me ç'rast në mënyrë brutale u janë shkelur të drejtat elementare dhe se me gjithë përpjekjet që janë bërë për stabilizimin e plotë të gjendjes në qytetin e Mitrovicës, e posaçërisht në pjesën veriore, edhe pse janë arritur rezultate të mira dhe se gjendja e sigurisë është normalizuar, strukturat drejtuese të komunës në veri të qytetit nuk kanë qenë në shërbim të qytetarëve dhe nuk kanë marrë masa për funksionimin e shtetit ligjor dhe zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës", ka thënë Bahtiri. Kështu, kryetari Bahtiri ka deklaruar se peticioni do të dërgohet të mërkurën në tri institucionet e Kosovës, te Qeveria, Kuvendi si dhe te presidenti, me ç'rast ai ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta miratojë këtë nismë të ndërmarrë nga qytetarët e Mitrovicës për bashkimin e qytetit.

# Jasharaj: Greva do të zgjasë derisa të realizohen kërkesat e mësimdhënësve

Të gjitha institucionet e arsimit në Kosovë të hënën kanë hyrë në grevë. Greva e mësimdhënësve ka filluar me kërkesat që koeficienti i pagës për mësimdhënës të ndryshojë në Ligjin për Paga që është në procedim. Sipas Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBAShK), pagat e parapara për mësimdhënës janë të padinjitetshme për punëtorët e arsimit. Kryetari i kësaj sindikate, Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se greva do të zgjasë derisa të realizohen kërkesat e mësimdhënësve



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 JANAR - Të gjitha institucionet e arsimit në Kosovë të hënën kanë hyrë në grevë. Punonjësit e arsimit, në të gjitha nivelet, nga ai parashkollor deri tek ai universitar, po kërkojnë rritje të pagave. Kjo rritje, sipas tyre, mund të realizohet përmes koeficientit të pagave, që pritet të rregullohet me Ligjin për pagat i cili aktualisht, në formën e projektligjit, është në procedurë të miratimit. Si pasojë e grevës, procesi mësimor është ndërprerë në të gjitha nivelet, duke filluar nga institucionet parashkollore e deri tek institucionet e arsimit universitar.

Këshilli Qendror Grevist i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBAShK) kërkon që të ngrehën koeficientet e parapara në Projektligjin e pagave për punonjësit e arsimit dhe kulturës, duke kërkuar koeficient të barabartë me sektorët të tjerë që janë nënpunës të shërbyesve publikë ose ngritje të koeficientit për punonjësit e arsimit, së paku 30 për qind.

Koeficienti i mësimdhënësve të arsimit fillor dhe të mesëm aktualisht, sipas SBAShK-ut, është 2 deri në 2.3 me pagë mesatare nga 420 deri në 440 euro, kurse kërkohet që ky koeficient të rritet në 2.6, respektivisht 3, që i bie paga të arrijë në rreth 650 euro.

Kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, pos vizitës që ka bërë të hënën në çerdhe, ai me anëtarë të Këshillit Qendror Grevist ka vizituar edhe Shkollën "Hasan Prishtina", ku kërkuan mbështetjen e të gjithë mësimdhënësve që, pavarësisht prej presioneve që mund të kenë nga prindërit e nxënësve, të mos zmbrapsen nga greva. Ai ka thënë se pa realizimin e këtyre kërkesave greva nuk do të ndërpritet. Sipas tij, projektligji për pagat është diskriminues për të punësuarit në arsim, ku nga 11 koeficientet e mundshëm, arsimi është vendosur në koeficientin e parafundit. "Ndërprerja e grevës nuk varet nga SBAShK-u. Sindikata ka pritur mjaft, greva do të zgjasë derisa institucionet e Kosovës t'i përfundojnë detyrat e tyre dhe t'i realizojnë kërkesat e mësimdhënësve, për të cilat vetë kanë thënë se janë legjitime dhe të drejta", ka thënë Jasharaj.

Projektligji për pagat aktualisht është duke u shqyrtuar në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në Kuvendin e Kosovës dhe me procedurë të shpejtë pritet të kalojë për miratim në njërën nga seancat e para të Kuvendit.

## Vetëvendosje: Qeveria është fajtore për grevën e mësimdhënësve

Përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje kanë akuzuar Qeverinë e Kosovës për hyrjen në grevë të mësimdhënësve. Deputeti i LV-së, Ismajl Kurteshi, ka thënë se këtë grevë nuk e kanë dashur mësimdhënësit, por janë detyruar si pasojë e kësaj qeverie. "Greva që nuk e deshën as mësimdhënësit erdhi si pasojë e kësaj Qeverie. Sikur Qeveria të mos i rriste pagat e veta, që me të drejtë nxiti shumë sektorë, nuk do të krijoheshin pakënaqësitë që janë sot. Sikur Qeveria të mos i injoronte shqetësimet e sindikatës sot fëmijët nuk do të mbetnin pa mësim. Është detyrë e kësaj Qeverie që së bashku me sindikatën të gjejnë një zgjidhje të arsyeshme që mësimi të fillojë", ka thënë Kurteshi. Ndërsa deputetja Arbërie Nagavci ka thënë se Qeveria dhe Ministria e Arsimit nuk i kanë marrë parasysh kërkesat e SBAShK-ut. "Nuk është sjell në votim të dytë Projektligji për pagat dhe është e qartë se vetë koalicioni qeverisës e ka vonuar këtë ligj. Qeveria, e cila falë dhjetëra miliona euro, që e stërmbush Qeverinë me këshilltarë, nuk merret aspak me zgjidhjen e këtyre problemeve. Është e papranueshme që projektligji për pagat parasheh rritje për presidentin kryeministrin dhe jo edhe për mësimdhënësit", është shprehur Nagavci.

# 451 raste për tri ditë në Emergjencë, 20 të lënduar në aksidente komunikacioni

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 JANAR - Në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për tri ditë janë trajtuar 451 persona. 74 pacientë kanë marrë shërbime mjekësore në dhomën e reanimimit, 98 raste ishin të karakterit kirurgjik, kishte 161 pacientë internistikë dhe 95 ortopedikë. Në këtë kohë janë kryer 24 intervenime të shpejta kirurgjike. Si pasojë e aksidenteve në trafik, 20 persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Për mjekim të mëtutjeshëm, në klinikat e QKUK-së janë pranuar 32 pacientë. Po ashtu, për tri ditë në Emergjencën e Pediatrisë janë trajtuar 212 fëmijë. Në reparte të ndryshme të Klinikës së Pediatrisë në QKUK për trajtim të mëtutjeshëm janë pranuar 53 pacientë. Në bazë të të dhënave, 36 pacientë janë kontrolluar në ambulanca specialistike.

### Për tri ditë lindën 69 foshnja në QKUK, tri raste me binjakë

66 lindje janë regjistruar fundjavën e shkuar në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

40 foshnja janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 29 të gjinisë femërore.

Tri nëna lindën binjakë.

21 lindje u realizuan me operacion, kurse 28 gra u bënë nëna për herë të parë.




Kurse gjatë katër ditëve, në Klinikën e Biokimisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë kryer 20 972 analiza laboratorike për 4 833 pacientë.

# Vazhdon paqartësia shtetërore ndaj dorëheqjeve të kryetarëve në veri

Ndonëse janë bërë gati dy muaj që kur kanë dhënë dorëheqje katër kryetarët e komunave në veri, ende nuk ka ndonjë vendim të institucioneve të Republikës së Kosovës lidhur me këtë çështje. Opozita konsideron se mosshkarkimi i kryetarëve të dorëhequr dhe mosshpallja e zgjedhjeve mund të jetë parapërgatitje për ndarje të veriut. Mirëpo njohësit e proceseve politike thonë se shteti i Kosovës heziton t'i shpallë zgjedhjet në veri për shkak se serbët mund ta bojkotojnë procesin zgjedhor


Maja Filović (RFE/RL)

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 JANAR - Edhe më tutje vazhdon paqartësia shtetërore lidhur me dorëheqjet e katër kryetarëve të komunave në veri, Mitrovicë e Veriut, Zubin-Potok, Leposaviq dhe Zveçan, ndonëse janë bërë gati dy muaj që kur është marrë ky vendim. Zyrtarët qeveritarë të kontaktuar nga gazeta "Epoka e re" nuk kanë dashur të flasin të dielën për këtë çështje, duke sugjeruar që të kontaktohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Por, partia më e madhe opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), konsideron se mosshkarkimi i kryetarëve të dorëhequr dhe mosshpallja e zgjedhjeve mund të jetë parapërgatitje për ndarje të veriut. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se kryetarët e komunave në veri në vendit do të duhej të shkarkohen meqë nuk po e pranojnë Republikën e Kosovës, në të cilën kanë konkurruar për kryetarë të komunave.

Ai ka thënë se në këtë rast institucionet po e shkelin ligjin. "Arsyetimi se kryetarët e këtyre komunave u janë drejtuar institucioneve të Kosovës me 'Kosovë e Metohi' nuk justifikon heshtjen e Qeverisë dhe ministrisë përgjegjëse. Në të kundërtën, ata do të duhej të shkarkohen për faktin se nuk po e pranojnë Republikën e Kosovës, në të cilën kanë konkurruar për kryetarë të komunave. Në këtë rast institucionet po e shkelin ligjin. Konservimi i gjendjes në veri jashtë komunikimit me institucione qendrore, frikësohem se është akt i paramenduar për pazare territoriale me Serbinë, për çfarë LDK-ja nuk pajtohet dhe nuk do të pajtohet me asnjë kusht", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka pyetur publikisht drejtuesit e institucioneve shtetërore se çfarë është duke ndodhur në veri të vendit. "Si kryetar i LDK-së dhe qytetar i Kosovës pyes institucionet përgjegjëse të vendit, Presidentin, Kuvendin, Qeverinë, institucionet e drejtësisë: a po ushtrohet sovraniteti shtetëror në komunat Leposaviç, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, në një sipërfaqe prej 1 005 km katrorë (jo hektar) të cilat përbëjnë 10 për qind të territorit të Kosovës? Në fund të nëntorit kryetarët e këtyre komunave deklaruan se dorëhiqen dhe e ndërprenë komunikimin me Prishtinën (organet qendrore). Çfarë po ndodh me dhe në veriun e vendit, a di kush?", ka deklaruar Mustafa.

Ndërsa njohësi i proceseve politike dhe ish-anëtari i KQZ-së, Blerim Burjani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shteti i Kosovës heziton t'i shpallë zgjedhjet në veri për shkak se serbët mund ta bojkotojnë procesin zgjedhor. Sipas tij, kjo lojë politike në veri do të vazhdojë derisa të rinisë dialogu dhe të hiqet taksa. "Ata nuk janë legjitimë pas dorëheqjes, pra nuk kanë legjitimacion veprimi. Ky është më tepër interpretim politik dhe për qëllime politike. Atje aktualisht nuk ka pushtet legjitim fare. Mosshpallja nuk nënkupton edhe ndarje. Kjo s'ka të bëjë me këtë temë fare. Ky është inspirim i trurit, por jo edhe fakt tregues se kjo do të ndodhë. Krejt çka po ndodh në veri është lojë politike për qëllime të shumta. Po të ishte kështu siç po thonë opozitarët, ata do të mbeteshin edhe më tutje kryetarë, por ata nuk e kanë këtë qëllim. Ata po vazhdojnë të zbatojnë urdhrin e Vuçiqit për ndalje të punës si kërkesë për ta hequr taksen. Po meqë kjo nuk po ndodh, ka mbetur një status quo", ka thënë Burjani.

Ai ka theksuar se ndarje nuk ka, por do të ketë presion për zgjidhje të favorshme për veriun. "Kjo politikë dirigjohet qartë nga Vuçiqi, prandaj mosshpallja e zgjedhjeve nuk ka të bëjë me skenar për të tjerë, por me të vetmin skenar për pritjen e vazhdimit të dialogut dhe heqjen e taksës. Po të shpallen zgjedhjet serbët nuk do të dalin në këto zgjedhje fare", është shprehur Burjani, duke shtuar se e logjikshme dhe ligjore do të ishte që përkohësisht kryetarët e dorëhequr ta vazhdojnë punën deri në zgjedhje të reja. "Ka një hezitim të veprimit institucional, pra ka një frenim të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve nga presidenti. Një fakt tjetër pengues është edhe mosfunksionimi i KQZ-së. Qeveria dhe presidenti nuk dëshirojnë ta pranojnë faktin e dorëheqjeve të kryetarëve të komunave veriore. Ka shumë pak të dhëna se si funksionojnë këto komuna pas dorëheqjeve. E logjikshme dhe ligjore do të ishte që përkohësisht kryetarët e dorëhequr ta vazhdojnë punën deri në zgjedhje të reja, por s'ka asnjë deklarim deri më tash në këtë drejtim. Është një status quo e zhvillimeve në veri. Institucionet e shtetit të Kosovës nuk i pranojnë dorëheqjet, por nuk kanë zgjidhje për këtë përderisa dialogu pritet të vazhdojë dhe kryetarët e dorëhequr presin heqjen e taksës. Nëse kjo ndodh ata mund të rikthehen. Në këtë situatë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kryeministri dhe të tjerët, duhet t'ua kërkojnë atyre ushtrimin e detyrave deri në zgjedhje. Përndryshe, s'ka kurrfarë informata se si funksionojnë këto komuna apo funksionojnë në heshtje si më herët", ka deklaruar ai.

Sipas Burjanit, veprimi i vetëm mbetet bartja e funksioneve të veprimit tek administrata komunale deri në një zgjidhje tjetër. "Nëse nuk pranojnë të ushtrojnë funksione deri në zgjedhje atëherë zgjidhje tjetër është emërimi i përkohshëm apo bartja e autorizimeve të përkohshme për administratën komunale ku shërbyesit civilë atje, përmes drejtorëve të administratës, do t'i kryejnë të gjitha shërbimet për qytetarët deri në zgjedhje. Pra, duhet të shkohet me emërime të përkohshme, ku autorizimet i barten administratës komunale deri në zgjedhje të reja", ka theksuar Burjani.

# Haradinaj: Taksën e heqim vetëm pas garancisë për njohje të Kosovës

**Prishtinë, 14 janar (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka theksuar se Qeveria e Kosovës do ta pezullonte përkohësisht tarifën ndaj importeve serbe vetëm pas garancisë ndërkombëtare për një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, e cila duhet të rezultojë me njohjen reciproke. Haradinaj ka thënë se përderisa kemi vetëm sugjerime për takime dialoguese të pafrytshme, pa objektiv dhe pa afate qartë të përcaktuara, pa kontratë të paradakorduar dhe garanci ndërkombëtare, që do të nënshkruhet marrëveshja për-



fundimtare që rezulton me njohje, taksa vazhdon të mbetet në fuqi. "Jam thellësisht i bindur për mundësinë e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjërisht obliguese me Serbinë, që rezulton me njohje. Ne intensivisht po punojmë për një kontratë përfundimtare, marrëveshje finale, me ç'rast edhe dorëzuam Librin e Madh me kapituj dhe Draftin e kësaj marrëveshjeje. Tërë këtë përmbajtje e kemi zhvilluar me qëllim për t'u siguruar se kur ulemi me Serbinë të kemi materie të qëndrueshme, me fakte dhe argumente. Vendosja e taksës ndaj produkteve të Serbisë nuk ka për qëllim pengimin dhe prolongimin e arritjes së marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjërisht obliguese me Serbinë që rezulton me njohje", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se, përkundrazi, Qeveria e Kosovës do ta pezullonte përkohësisht taksën. "Vetëm pas garancisë ndërkombëtare, se do të ulemi për ta nënshkruar marrëveshjen përfundimtare, e cila duhet të rezultojë me njohjen reciproke. Garanca do të thotë që ekziston një materie, kontratë në parim dhe pret vetëm nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, që rezulton me njohje", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Bisedë me kryetaren e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala

# ‘Trepça’ s’duhet të jetë pjesë e bisedimeve në Bruksel



Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, ka thënë se çështja e "Trepçës" assesi s'do të duhet të jetë pjesë e tavolinës së diskutimeve në Bruksel. Sipas saj, për këtë gjë duhet të bëhet unifikimi i spektrit politik në vend dhe të punohet për draftstatutin zhvillimor të kësaj ndërmarrje

## Çfarë thotë neni 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]

Në këtë nen kushtetues thuhet: "1. Populli i Republikës së Kosovës, në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund t'i gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund t'i shkelë obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik. 2. Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat janë përcaktuar me ligj me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë në pajtim me ligjin. 3. Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksploatimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj".

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**Prishtinë, 14 janar** - Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Sala Berisha-Shala, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se çështja e "Trepçës" duhet të zgjidhet sa më parë të jetë e mundur që, sipas saj, opozita duhet ta kalojë vetveten dhe për çështje madhore siç është "Trepça" ta bëjë kuorumin dhe bashkërisht të punojnë drejt zhvillimit të kësaj ndërmarrje. "Bordi i 'Trepçës' është peng i draftstatutit dhe disa kërkesave të sindikalistëve dhe s'mund të kërkojmë diçka nga ta kur ende s'kanë pasur mundësi t'ia fillojnë punës", ka thënë Berisha Shala, duke aluduar kështu në neglizhencën që po bëhet në kalimin e draftstatutit nga partitë opozitare. "Mungesa e kuorumit automatikisht na ka bllokuar, edhe pse do të duhej të ishte e kundërta që për çështje të rëndësishme ekonomike dhe sociale do të duhej t'i tejkalonim ngjyrimet politike. Mirëpo, zgjedhjet e fundit e kanë krijuar një situatë që as opozita nuk i ka numrat për ta shkarkuar qeverinë dhe e as pozita për t'i çuara përpara proceset. Në rastin e 'Trepçës' është dashur ta tejkalojmë vetveten të gjithë dhe ta lëmë lakminë për pushtet, pra të bëhemi bashkë në miratimin e statutit të kësaj ndërmarrje", është shprehur ajo.

Ndërkaq sa i përket neglizhencës së punës nga spektri politik për këtë ndërmarrje, Sala Berisha-Shala ka thënë se duhet të jenë njëzëri dy taborët politikë dhe assesi mos të lejojnë që dikush nga jashtë të ketë apetit për "Trepçën". "Jam e pirur së pari të bëj me gisht nga vetvetja, çfarë bëra unë dhe cila ishte puna ime në atë drejtim. Unë u kam thënë disa herë individualisht deputetëve të opozitës, me qasjen e juaj ndaj 'Trepçës' ju po sillni në tavolinë të bisedimeve në Bruksel. Sjelljet tona duhet të jenë të atilla që ne t'i përfundojmë punët tona, për ta miratuar statutin dhe për ta funksionalizuar 'Trepçën'. Pra, t'i përdorim të gjithë mekanizmat ligjorë dhe kushtetues që t'ua pamundësojmë apetitet dikujt tjetër nga jashtë", ka thënë ajo, e cila për këtë çështje ka cituar nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. "Minierat dhe mineralet janë kategori kushtetuese Ky është mendimi im i bazuar edhe në Kushtetutë dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet të sillen në tavolinë të bisedimeve 'Trepça' ose minierat", ka deklaruar ajo.

Ndërkaq sa i përket problemit tjetër të "Trepçës", definimit të aseteve të kësaj ndërmarrje në të gjithë ish-Jugosllavinë, Berisha-Shala ka thënë se AKP-ja është duke u marrë me këtë çështje. "Për asetet e 'Trepçës' është Agjencia Kosovare e Privatizimit e cili është duke identifikuar asetet, një herë identifikohen, më pastaj u jepet statuti. Se a do të privatizohen apo çfarë do të ndodhë mbetet të identifikohen, pasi në tërë ish-Jugosllavinë kishte asete, si pushimore të punëtorëve, fabrika dhe asete të ndryshme", ka thënë deputetja Sala Berisha-Shala. Përveç aseteve në Kosovë, 31 prona të këtij kombinati gjenden në republikat e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë këtu fabrika, zyra dhe objekte të tjera.

# Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit: Rrugët janë të kalueshme

**Prishtinë, 14 janar (ER)** - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka njoftuar se, pavarësisht se mëngjesin e së hënës kanë rifilluar reshjet e borës, rrugët që janë në përgjegjësi të këtij dikasteri janë të pastruara dhe të qarkullueshme. Ekipet e kësaj ministrie janë në monitorim të vazhdueshëm të situatës dhe të gatshme të intervenojnë përkitazi me situatën. Për rrugët që janë të kalueshme nga bora ka reaguar përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" edhe ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj. "Bora rifilloi, por kjo nuk paraqet problem në qarkullim të automjeteve. Rrugët janë të pastruara dhe ekipet po e monitorojnë situatën nga afër në të gjitha pjesët që janë nën përkujdesje të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Mos dilni pa pajisjet dimërore dhe kujdes shpejtësinë!", ka shkruar ministri Lekaj.



# Haradinaj: Pavarësisht prej sfidave që do t'i kemi, fokusin do ta kemi në ekonomi

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në takimin e nëntë me radhë të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, ka thënë se ky vit është vit i ekonomisë dhe, sipas tij, Qeveria do t'u kthehet seriozisht temave ekonomike



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 JANAR - "Ky vit është vit i ekonomisë dhe do t'u kthehemi seriozisht temave ekonomike, si: riaktivizimit të mirëfilltë i Këshillit Kombëtar për Zhvillimit Ekonomik (KKZhE), krijimit të Sekretariatit të Përhershëm të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe të odave dhe veprime të tjera të rëndësishme në këtë fushë". Kështu ka deklaruar kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në takimin e nëntë me radhë të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik.

Haradinaj ka potencuar faktin se Kosova ka politikën tatimore më të volitshme në rajon dhe Qeveria dëshiron t'i dëgjojë bizneset edhe më tutje për reformat dhe veprimet e tjera që lidhen me investitorët e huaj, duke e ditur se janë 11 investitorë strategjikë të paraqitur dhe njëkohësisht investimin më të madh që pritet të jetë në fazën implementuese me vlerë prej 1.8 miliard eurosh, investimi në energji me "Contur Global" dhe hapat e tjerë të rëndësishëm që janë ndërmarrë nga Qeveria, siç është edhe krijimi i zonave ekonomike, me theks të veçantë Parku Inovativ Trajnues në Prizren dhe Zona e Veçantë Ekonomike Amerikane në Gjakovë. "Ne duhet të vazhdojmë së bashku reformat në fushën fiskale, Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimi në të ardhurat personale ka kaluar në lexim të parë, Ligji për TVSh-në dhe Ligji për Administratën Tatimore dhe përgjegjësitë është proceduar në Kuvend", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se mbetet edhe çështja e informalitetit, por përmendi ligjet, si Ligji i pagave, i Festave Zyrtare, Ligji i punës, që krijojnë lehtësira në biznes.

Më tutje, Haradinaj ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë të cilët sjellin nga ekspertiza, përvoja dhe dije, por tha se ekzistenca e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik duhet të dëshmohet me veprimet që burojnë nga ai dhe ka kërkuar të jenë kërkues sepse, me gjithë sfidat që do të dalin, fokusin do ta kenë në ekonomi.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar edhe nevojën që këto takime të mbahen një herë në muaj si pjesë e rëndësishme për të avancuar temat e ekonomisë. Kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga anëtarët e këtij këshilli që të vijnë me propozime konkrete dhe t'u qëndrojnë pas temave me të cilat obligohen në mënyrë që të kemi rezultate më evidente në fushën e ekonomisë.

Ndërsa ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka thënë se institucionet pjesëmarrëse të KKZhE-së, bashkë me komunitetin e biznesit, kanë qenë aktivë në punët e përbashkëta për t'i adresuar prioritetet dhe sfidat kryesore dhe për t'i zbatuar reformat gjithëpërfshirëse që kanë për qëllim përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, eliminimin e barrierave, forcimin e ndërmarrjeve në Kosovë, tërheqjen e investimeve të huaja direkte në vend. "Duke u nisur nga fakti se Qeveria e Kosovës këtë vit e ka shpallur vit të ekonomisë, ne si institucione pjesëmarrëse në këtë forum do ta japim kontributin tonë për të ngritur dhe diskutuar shumë çështje që do të ndikojnë pozitivisht në sferën ekonomike në aktivitetin e shtuar të bizneseve, në rritjen e investimeve të huaja në vend dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovë", ka thënë ministri Shala.

Ndërkaq ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka njoftuar për veprimet e ndërmarra në reformën e trajtimit të marrëdhënieve kontraktuale punëdhënës-punëmarrës, përfshirë edhe pushimin e lehonisë. Me këtë rast, ministri Reçica ka thënë se Projektligji i punës adreson të gjitha çështjet nga marrëdhënia e punës dhe janë marrë praktikat më të mira të vendeve të BE-së, po ashtu janë eliminuar çështjet që kanë qenë problematike në Ligjin aktual të punës. Po ashtu, ministri Reçica ka thënë se ky projektligj rregullon pushimin e lehonisë, pushimin prindëror dhe të atësisë. Ai ka theksuar se pushimi i lehonisë parashihet të jetë 12 muaj, ku për tre muajt e parë pagesa do të bëhet nga punëdhënësi me 70 për qind të pagës bazë, gjashtë muaj nga qeveria me 50 për qind të pagës mesatare në vend dhe tre muaj të tjerë pa pagesë jo obligative.

Ky projektligj parasheh edhe pushimin prindëror pa pagesë nga 4 muaj për secilin prind derisa fëmija t'i mbushë dy vjet. Po ashtu, për herë të parë me këtë projektligj trajtohen edhe lehonat e papunësuara të cilat në bazë të këtij ligji do të përfitojnë në afat prej 6 muaj një kompensim mujor në vlerë të caktuar të pagës minimale në vend.

Përfaqësuesit e bizneseve janë shprehur të kënaqur me reformat fiskale që ka ndërmarrë Qeveria, duke potencuar se këto reforma kanë ndikuar në zhvillimin e tyre. Në këtë takim është diskutuar edhe për Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, Ligjin për Partneritetin Publiko-Privat, menaxhimin e pronave të "Ekonomisë së pyjeve" etj.

# Zvicra përkrah promovimin e produkteve bujqësore të Kosovës në tregun zviceran



PRISHTINË, 14 JANAR (ER) - Zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka pritur të hënën në një takim presidentin e Dhomës së Tregtisë, Industrisë dhe Shërbimeve Zvicër - Kosovë, Stefan Sarkany, bashkë me një delegacion të kësaj organizate, me të cilët kanë biseduar për mundësinë e bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë përmes promovimit të produkteve bujqësore të Kosovës në tregun zviceran. Me këtë rast, zëvendësministri Krasniqi i ka njoftuar ata me programet e ministrisë për zhvillimin e bujqësisë në vend, të cilat programe, sipas tij, kanë sjellë rezultate dhe falë investimeve në bujqësi është siguruar edhe rritje e cilësisë së produkteve bujqësore të prodhuara në vend, të cilat tashmë po depërtojnë edhe në tregun rajonal dhe evropian.

Gjatë këtij takimi, zëvendësministri i ka falënderuar drejtuesit e kësaj organizate për gatishmërinë e tyre për fillimin e bashkëpunimit në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore pasi, sipas tij, përvoja dhe ndihma e Zvicrës është e mirëseardhur, duke ditur faktin se ky shtet është i njohur për prodhimin e disa produkteve blegtorale. Nga ana e tij, presidenti i Dhomës së Tregtisë, Industrisë dhe Shërbimeve Zvicër - Kosovë, Stefan Sarkany, ka vlerësuar të arriturat në sektorin e bujqësisë në vend dhe ka theksuar gatishmërinë e tyre për ta mbështetur depërtimin e produkteve bujqësore dhe industrinë ushqimore "Made in Kosova" në tregun zviceran. Për këtë ata treguan se janë të gatshëm ta fillojnë këtë bashkëpunim me prodhuesit dhe përpunuesit e industrisë ushqimore në vend.

# Ahmeti realizon premtimin për shujta të ngrohta

Prishtinë, 14 janar (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se kryetari i kësaj komune, Shpend Ahmeti, ka realizuar premtimin për shujta të ngrohta për personat në nevojë. "Shujta të ngrohta për personat në nevojë, është një nga zotimet e Shpend Ahmetit në fushatën e vitit 2017 i cili u realizua. Ky projekt ka për qëllim rritjen e solidaritetit mes qytetarëve të Prishtinës, barazinë dhe mirëqenien. Sonte në orën 18:0, Kuzhina Popullore do të jetë në shkollën 'Xhemajl Mustafa' në Dardani, ku bashkë me shumë vullnetarë do t'u shërbejmë ushqim atyre qytetarëve me kushte të rënda sociale", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.





# Qyteti i Deçanit bëhet me furnizim alternativ të energjisë elektrike

Deçan, 14 janar (ER) - KEDS-i përmes një komunikatë për media ka bërë me dije se ka finalizuar punimet për vendosjen e kabllos alternative për qytetin e Deçanit, duke krijuar stabilitet dhe siguri shumë më të madhe të furnizimit me rrymë. "Kompania ka shtrirë kabllon alternativ 2 400 metra të gjatë që lidhet në largpërçues. Tani qytetarët e Deçanit, në rast të ndonjë prishje, nuk do të kenë ndalesa të gjata të energjisë elektrike, pasi ka mundësi alternative të furnizimit. Kjo kabllo do të shërbejë si furnizuese e pjesës më të madhe të qytetit të Deçanit derisa të rregullohet ndonjë prishje e paraqitur apo ndonjë e papritur tjetër që mund të ndodhë. KEDS-i ka intervenuar në këto temperatura të ulëta ta shtrijë këtë kabllo, pasi kohën e fundit ka pasur probleme të furnizimit të këtij qyteti si rrjedhojë e dëmtimit të kabllos nëntokësore. Por, ndalesat disaorëshe tashmë janë evituar. Kjo edhe falë përkushtimit maksimal të punëtorëve të KEDS-it dhe përkrahjes së vazhdueshme nga ana e Komunës së Deçanit", është thënë në komunikatën e KEDS-it.

# Më 23 janar në Mitrovicë mbahet akademi përkujtimore për Isa Boletinin

Mitrovicë, 14 janar (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar disa pika të rendit të ditës me rëndësi për qytetarët. Fillimisht drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka njoftuar bordin që më 23 janar do të mbahet akademi përkujtimore me rastin e 103-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar Isa Boletini, e cila do të organizohet nën përkujdesjen e kryetarit të komunës, Agim Bahtiri, dhe ekzekutivi ishte i pajtimit që të jetë një organizim në nivel shumë të lartë duke marrë parasysh figurën madhore të heroit kombëtar Isa Boletini. Ndërsa drejtori i Arsimit, Iset Beka, ka thënë se në të gjitha shkollat në Mitrovicë dhe fshatrat përreth janë bërë përgatitjet e duhura për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë shkollor, pajisja me lëndë djegëse dhe të gjitha kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen e mësimit mirëpo, sipas tij, Këshilli Drejtues i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK-u) ka vendosur që ta shpallë grevën e përgjithshme në arsim dhe mësimdhënësit e Komunës së Mitrovicës i janë përgjigjur kësaj greve.



# Komuna e Kaçanikut e angazhuar për pastrimin e rrugëve nga bora



Kaçanik, 14 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, dhe nënkryetari Ylber Bajra, kanë drejtuar mbledhjen e fillimjavës së ekzekutivit komunal, në të cilën janë njoftuar me punët dhe aktivitetet javore si dhe me planifikimet për javën që sapo kemi filluar. Përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave kanë bërë me dije se gjatë tërë javës kompania e kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve nga bora ka qenë e angazhuar në vazhdimësi për pastrimin e rrugëve në lagjet dhe fshatrat e Komunës së Kaçanikut. "Në vendet me ngrica dhe më të rrezikuara është hedhur edhe kripë industriale si dhe zhavorr. Momentalisht të gjitha rrugët janë të kalueshme, por me vështirësi qarkullimi në zonat më të thella malore. Komuna e Kaçanikut është në gjendje gatishmërie për pastrimin e rrugëve nga reshjet e tjera eventuale të borës. Në takim u diskutuan edhe punët dhe aktivitetet javore që do të realizohen në javën që sapo kemi filluar nga drejtoritë dhe sektorët komunalë", ka njoftuar Komuna e Kaçanikut.

# E kujt është qeverisja: personale e Ramës apo e socialistëve?



Nga Bedri ISLAMI

Debati, në dukje konstitucional, në fakt shterp, se kujt i takon e drejta e emërimit të kabinetit qeveritar, la në hije faktin tjetër, që është, po ashtu, tejet i diskutueshëm dhe tek i cili është harruar ndalja.

Presidenti Meta dekretoi në grupin e dytë të miratimit të ministrave katër prej tyre, pasi më parë, duke mos pasur asnjë lloj arsyeja për shtyrje, kishte dekretuar katër deputetë, të cilët, për vetë pozicionin e tyre, ishin të patjetërsueshëm.

Tani, Anila Denaj, si ministre e Financave, Besa Shahini, si ministre e Arsimit, Belinda Balluku, si ministre e Energjisë dhe Elva Margeriti, si ministre e Kulturës, presin një akt më se formal, miratimin e tyre nga shumica qeverisëse, njëkohësisht parlamentare, pavarësisht se disa prej tyre kanë qenë e vazhdojnë të jenë krejt të panjohur. Kartonët do të ngrihen duke i dhënë dritën jeshile suportit të tyre qeveritar.

Të gjithë propozimet, së bashku me lëvizjet e tjera, ishin zgjedhje ekskluzive e shefit të qeverisë, Edi Rama, i cili, në parim ka edhe tagrin për të bërë ndryshimet e tij qeveritare. Njëra nga ministrat e ardhshëm, Besa Shahini, vjen nga shqiptarët e përtej Drinit, nga Kosova dhe ka qenë militante e Lëvizjes VV. Nga kjo lëvizje vjen edhe i pamandatuari në postin e ministrit të Jashtëm, dhe "molla e sherrit" qeveri - presidencë, Gent Cakaj.

Belinda Balluku ka qenë një funksionare e Bashkisë së kryeqytetit, kur drejtonte Rama dhe e njohur e vjetër e tij. Anila Denaj nga bota e financës, Elva Margeriti nga një funksion tjetër anësor. Nuk është e rëndësishme pozicioni i saj si këshilltare pranë qeverisë Rama, ashtu si nuk ka asnjë rëndësi për temën e këtij shkrimi rruga që kanë bërë anëtarët e rinj të kabinetit.

Rama, papritmas, i propozoi ata, kur asnjëri nuk e dinte dhe kur, si ndodh në politikën tonë, askush nga ajo sallë e madhe dhe me emër të madh, si Asamble Socialiste, nuk e dinte dhe që, kur kryeministri po lexonte emrat, disa i binin me bërryl njëri-tjetrit dhe pyetnin nëse i njihnin ministrat e rinj.

Askush nuk e mohon të drejtën e shefit të qeverisë për të bërë kabinetin e tij qeverisës. Ai e ka këtë tagër, por përtej këtij tagri dhe ndoshta i vendosur mbi të, është një e drejtë tjetër, e organit politik më të lartë që i ka deleguar të drejtën shefit të partisë për të qeverisur.

Të gjithë të emëruarit e momentit të dytë presidencial nuk kanë asnjë lidhje me strukturat e Partisë Socialiste. Ata kanë qenë, ndoshta edhe do të jenë, jashtë strukturave të saj. Do të jenë ndoshta nga të paktët përfaqësues qeveritarë të një force politike që nuk i takojnë. Nuk e di as nëse e njohin programin e saj politik dhe ekonomik, idenë fillestare të Rilindjes si koncept qeverisës, pengesat që ka pasur dhe gabimet e fajet që janë bërë; nuk e di nëse kanë dijeni se kush është në drejtimin e saj, ashtu si nuk e di nëse të gjitha, pesë vite më parë, kanë votuar për të.

Ideja se kryepushtetari politik dhe kryepushtetari qeverisës, duke qenë i njëjti, mund të bëjnë si të duan jashtë forumeve, për të cilat as nuk pyesin, e asfikson këtë të fundit. E bën të pajehonë, zëmbytur dhe të nënshtruar deri në rrënjë ndaj mendimit të çastit kryeministror, e nxjerr atë në jashtëlojën e pazakonshme dhe e bën apatike për vetë emrat e propozuar dhe për të cilët, pas pak ditësh do të duhet të votojnë.

Zgjedhjet parlamentare, qoftë pesë vite më parë, qoftë para një viti, askush, as edhe vetë Rama, nuk i ka fituar i vetëm. Miti se një njeri mund të bëjë gjithçka, pa ndihmën e strukturave, është kaq shumë i gabuar, sa që, vetëm kur bien nga fiku i pushtetit, e kuptojnë se sa të vetmuar janë.

Tepsinë e pushtetit e kanë fituar së bashku, që nga votuesit e zakonshëm, deri tek militantët e shumtë dhe të heshtur.

Duke qenë e drejtë ekskluzive e kryeministrit është njëkohësisht edhe e drejta e strukturës politike që drejton dhe që është rropatur e ka bërë gjithçka që ka mundur për të fituar pushtetin.

Dështimi i ekipit qeveritar, nëse ndodh, nuk do të jetë vetëm ndëshkim i një njeriu, por i tërë forcës politike që e ka mbështetur atë dhe i ka besuar drejtimin.

Nëse gjysma e kabinetit është jashtë forcës politike ai mund të jetë lehtësisht një kabinet teknik, por jo i një force politike.

Përse ndodh kështu?

Ka shumë arsye, që nga ajo që përcakton saktësisht Bajroni në poemën e tij të famshme, "Çajld Harold", vetia e trashëgueshme e shqiptarëve për të shkuar nga i çon i pari i tyre, e deri tek ligji i tashëm elektoral, që shefin e partisë e bën brenda forcës së tij politike si njeriun që hedh shi e sjell borë, që bën diellin dhe hënën dhe që, vetëm përmes tij mund të jesh dikush.

Kryetari i partisë është zoti që e bën partinë si të dojë e kur të dojë. Ai bën listat e deputetëve, vendos për kryetarët e ardhshëm të bashkisë, për ministra e zëvendës të tyre, ai i sjell ligjet dhe i ndryshon. Pra, ai është i plotfuqishmi që vendos. Të tjerat janë formalitete të padobishme për vetë konceptin e tyre politik.

Kështu kanë bërë të gjithë, kështu bën edhe Rama.

A kanë socialistët njerëz të aftë, figura të njohura qeverisëse dhe të pakonsumuara nga mëkatet e shumta?

Sigurisht, po. Kanë më shumë se sa për një qeveri. Kanë financiarë dhe ekonomistë të aftë, njerëz të dinjitetshëm që nuk pranojnë bjerrjen e ndërgjegjes për hir të postit, kanë filozofë dhe dijetarë, kanë mjeshtër të politikës së jashtme dhe të kulturës, profesorë të shquar në fushën e arsimit, të cilët kanë hedhur atë rrënjë frymëzuese në radhët e socialistëve të moderuar.

Anashkalimi i tyre si një bjerrje kohe dhe vendosja në masë kaq të madhe të një rrjeti "asnjanës", kur është fjala për të zbatuar një program politik, mendjelehtësia me të cilën tejkalohen strukturat, të cilat, sipas statutit duhet të vendosin, befasia e emërimeve dhe e riciklimit politik e administrativ, të gjitha së bashku e veç e veç, të çojnë drejt krijimit të një aureole, që mund të shembë statujën.

Asnjëherë lider i opozitës, edhe ata që ndjellin vdekjen e tij, edhe ata që e kërcënojnë se do e hedhin në Lanë, nuk kanë ngritur një ide për anashkalimin e forumit të partisë.

Sepse, edhe më shpesh se vetë Rama, ata e bëjnë këtë. Mjafton të kujtosh kandidimet skandaloze të Bashës në zgjedhjet e qershorit të shkuar, ku listat pasi kalonin përmes familjes së tij, në tri a katër herë radhazi , dorëzoheshin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, çka e detyroi Genc Rulin të ulërinte për t'i nxjerrë jashtë me shkelma kunatin e gruan bashkëshortore të liderit opozitar.

Qeverisja, më parë se të jetë e Ramës, është e socialistëve.

Sa herë ai është mbështetur në këtë koncept, aq herë edhe i ka dalë për mbarë.

Sa herë e ka harruar atë ka pasur të papritura jo të dobishme në udhëtimin e tij politik.

Rama nuk e bëri, por e gjeti radhën e socialistëve në pushtet.

Nuk e risolli i vetëm. Problemi madhor është që, nëse një ditë ai bie, mos të bjerë me të edhe gjithë ajo që është ngritur mundimshëm që nga viti 1991.

# Më mirë gjeneral me kokë të ngrënë se rob me biografi të pastër

Shkruan: Ismail SYLA

Për aq sa më mbeti merak që nuk e përcolla Sami Lushtakun ose Rrustem Mustafën-Remin të dielën në aeroport, aq ma hoqi merakun një bashkëluftëtar i tyre, Sami Thaçi, i cili nuk ka shumë muaj që u lirua nga burgu, këtu në Kosovë. Në pamjet televizive dhe në fotot e botuara në portale, "gjenerali", siç jemi mësuar t'i themi Sami Lushtakut, dukej i qetë, i rrethuar nga anëtarët më të dashur të familjes, nga djemtë, vajzat, nipat dhe mbesat. Në një foto posaçërisht gruan e tij e tradhtonte qetësia. Ajo sikur ka një fytyrë në të cilën është ngurosur një brengë dhe pikëllim. Dhe me të drejtë. Nuk është lehtë që pas 19 vjet nga përfundimi i luftës të përcillet shtylla e familjes në një gjykatë jashtë vendi. Nuk është lehtë që gjatë 19 viteve të lirisë së Kosovës, njëri nga bashkëluftëtarët kryesor të Adem Jasharit të ketë herë një arrestim, herë një tjetër, herë një gjykim, herë një tjetër.

Pyetjeve të gazetarëve për këtë udhëtim drejt Hagës, dy komandantët e njohur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sami Lushtaku dhe Rrustem Mustafa iu përgjigjen me saktësi, pa nervozë dhe nuk ndjehen të bezdisur. Madje Sami Lushtaku në pyetjen se a ndjehet keq që ka marrë ftesë për t'u paraqiturit para hetuesve të dhomave të specializuar, thotë jo me ironi, por me shumëkuptimësi se do të ndjehej keq po të mos merrte ftesën. Ky është morali i një komandanti i cili nuk ka bërë rastësisht emër në mbarë Kosovën. Prapa emrit të tij qëndron një histori e tërë, prej një djaloshi rebel, deri tek një gueril i suksesshëm, tipare dhe cilësi të klasit të parë të nocionit "burrë" edhe në kuptimin tradicional, edhe në kuptimin e njerëzve që kanë tipare burrështetasi.

Atë që Sami Lushtaku e thotë me shumë kuptime, në anën tjetër, ish bashkëluftëtari i tij S. Thaçi e thotë me sinqeritet se më lehtë do të shkonte bashkë me të se sa t'i thoshte "udha e mbarë" njeriut me të cilin e lidhin edhe ditët e luftës në vitet 1998-1999, por edhe ditët e



kaluara në burgje, herë në Dubravë e herë në Gërrdofc. Në fakt thënia se do të ndjehej keq po të mos kishte ftesë tregon më së miri se sa i sigurt në vetvete është gjenerali Sami Lushtaku për pastërtinë e luftës së tij, për pastërtinë e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe, nëse duhet edhe njëherë të "rishikohet" ajo pastërti, atëherë kush më parë dhe më mirë se njëri nga gjeneralët e saj më të mëdhenj mund ta dëshmojë atë.

E, kur flitet për ngjarjet e djeshme, të nisjes për në Hagë, burri me emrin Besnik thotë se është mjerim t'i lexosh komentet e disa qytetarëve që nëpër rrjetin social të Facebooku-ut shprehin gëzim për fillimin e hetimit dhe intervistimit të figurave të larta të UÇK-së me mallkimin "shkofshi e mos u kthefshi"... e fyerje tjera dhe dashakeqësi të nivelit më të ulët. Ashtu si ngritja e emrit të trimërisë, burrërisë dhe lavdisë që ka një rrugë përshkuese, ashtu edhe ata që nuk hezitojnë ta shprehin hapur urrejtjen kundër komandantëve të UÇK-së kanë historinë e tyre, por me masa dhe vlera të kundërta. Këtë "pastërti" të atyre që shajnë dhe u gëzohen arrestimeve të komandantëve më së miri e paraqet mesazhi i një anekdote popullore shqiptare dhe një mjet amvisërie, që është gjëja e parë që më erdhi në mendje, luga.

Në një anekdotë të mbledhur nga Tahir Foniqi, më 1980, e treguar nga Islam Veseli, me titull "Me pas kanë trim..." (Lozicë, Prekorupë) zhvillohet ky dialog:

"Njani e kish pas zakon m'u livdu shum për trimni. Nji ditë i thotë njani:

- O jaran!
- O hoja!
- Po sa vjet i ke allahile?
- Nja gjashtëdhetëpo.
- E, sa dërzhava ki mrri m'u nrrue?
- Nja gjashtë a shtatë po se po.
- Boll, bre jaran, se me pas kanë trim, njana dërzhavë t'kish hangër deri tash".

Kjo anekdotë në së miri e pasqyron pozitën e njeriut në robëri. Këtu fjala sllave "dërrzhava" ka kuptim sa të një shteti të huaj sundues, asht edhe të regjimeve politike të një shteti të huaj. Ata që i gëzohen arrestimit të gjeneralëve, që më parë se të tillë ishin luftëtarë të lirisë, njerëz që luftën dhe veprimtarinë e tyre e bënë në tokën e tyre, në fakt e ekspozojnë hapur kompleksin e shpirtit të tyre rob, të mungesës së guximit qytetar.

Këta njerëz me "biografi të pastër" për dallim nga komandantët "njollosur" ma sollën ndërmend lugën e ushqimit. Ajo vërtetë ka ngjashmëri me ta, lahet, pastrohet e përvëlohet por historia e saj është histori e lugës së pastër, që shërben për të ngrënë gjellë.

Nisja drejt Hagës e dy gjeneralëve moralë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte me dinjitet, me integritet dhe shprehte krenarinë e njeriut që ka bërë luftë për liri dhe çlirim të vendit të tij, që ka vënë themelet e shtetit dhe demokracisë së vendit të tij.

Në çdo rrethanë, më mirë gjeneral me kokë të ngrënë, se lugë për të ngrënë gjellë.

# Tivari në vargje, tema e madhe e kujtesës kolektive shqiptare

(Ajet Shala, "Deti i varreve", (poemë), Prishtinë, 2018)

Prof. dr. Begzad BALIU

Tivari është një prej temave të përhershme në krijimtarinë letrare dhe historike e shumë shkrimtarëve dhe studiuesve të dekadave të fundit. Duke e përcjellë krijimtarinë e pasur dhe të vëllimshme letrare të Ajet Shalës, kam vënë re disa përbërës historiko-letrarë të përhershëm, si tema dhe motive, prej të cilave nuk është 'liruar' asnjëherë. Në radhë të parë nuk është 'liruar' nga tema e dy luftërave të Drenicës (1945) dhe (1999) dhe nga Tragjedia e Tivarit (1945), në të cilën ishin përfshirë djemtë më të mirë të gjithë Kosovës. Kjo temë e pati ngjizur edhe fillimin e miqësisë sonë, sepse edhe unë përpjekjet e mia hulumtuese i kam nisur duke bërë kërkime në projektet: "Gjurmëve të tragjedisë së Tivarit" dhe "Gjurmëve të krimeve të Brigadave Partizane në Kosovën Verilindore (1944-1945)", të cilat në formë fejtonesh i pata botuar në shtypin e Prishtinës.

Në një nga netët e bisedave tona internetike, shkrimtari Ajet Shala më kishte dërguar një poemë të tij kushtuar tragjedisë së Tivarit. Ishin tridhjetë e tri njësi tetë vargjesh. I lexova me një frymë. Pas shumë poezive kushtuar luftëtarëve legjendarë të këtij gjysmëshekulli dhe pas disa dhjetëra poezive kushtuar temave bosht të kësaj hapësire heroike, synimet e tij largvajtëse qoftë në prozë, poezi, apo në formë kujtimesh (intervista e reportazhe), i kishte kurorëzuar në një poemë, të cilën më vonë do ta pagëzojmë me titull "Deti i varreve", që në natyrën e toponimisë shqiptare do të duhej të identifikohej si "Varret e detit" (shih, Vorret e katunit, Te vorret n'fushë etj.), por që për autorin në frymën e poezisë më mirë tingëllonte "Deti i varreve". Pra, poemë për një det të mbushur me kufoma, që u bë varr i prehjes së tyre. Kërkesës së tij që ta vlerësoj nëse kjo poemë epike mund të hyjë në një vëllim me poezi, para së gjithash, lirike, iu përgjigja me konceptin e Sabatos: Për Tivarin është shkruar shumë në kontekstin historik, por Tivarit i mungon një vepër e madhe artistike (roman, dramë, film artistik, operë, pikturë etj.), prandaj për Tivarin ende nuk kemi një parafytyrim të plotë dhe të veçantë, që mund të krijojë vetëm arti letrar artistik, ende nuk kemi një përjetim estetik të kësaj tragjedie! Në këtë rrjedhë, i rekomandova mikut tim, që poemën ta plotësonte dhe ta botonte vepër më vete.

Përtej vlerave epike të trajtimit, kjo poemë më bindi për forcën krijuese të autorit për ta provuar veten më tej. Që me versionin e parë të tekstit të tij poetik më kishte bindur se ai me kërshërinë prej lexuesi dhe prej krijuesi, e kishte asimiluar që më parë poemën në letrat shqipe. Teksa e lexoja poemën e tij për Tivarin, ajo më kujtonte poemat e Dritëro Agollit ("Nënë Shqipëri", "Baballarët"), Koçi Petritit ("Ura e Drashovicës"), Beqir Musliut ("Skënderbeu"), Qerim Ujkanit ("I njëqindekatërti") dhe, përgjithësisht, poemat e lëvruara dendur në vitet '70-'80. Prandaj kërkesa ime për të hapur këtë temë të madhe me vargje dhe me situata të tjera historike e dramatike kishte arsye të plotë.

Prandaj, jam shumë i nderuar që poema e shkrimtarit Ajet Shala tani ka një përmbajtje dhe një strukturë shumë të pasur, prej 303 njësish, përkatësisht prej 2 424 vargjesh poetike. Ajo tani është një poemë, brenda së cilës është përshkuar jo vetëm një prej tragjedive më të mëdha të shekullit XX, po në një mënyrë a një tjetër reflektojnë të gjitha tragjeditë e kësaj natyre të shekujve të fundit. Poema "Deti i varreve" është një poemë e madhe letrare brenda së cilës janë strukturuar të gjithë përbërësit historikë, letrarë e artistikë të prirjeve dhe sprovave të autorit në fushë të letërsisë. Vargu i tij përgjithësisht me këtë poemë është pasuruar me thyerje të reja, me saktësime të rimës dhe të rrokjeve, me ritmin e brendshëm, ndërsa në strofën e tij tetë vargjesh janë shënuar saktësime tematike dhe përmbyllje kuptimore të saj.

Megjithëse e strukturuar si tetë vargjesh prej 303 njësish, ajo në esencë është një poemë e shtrirë në 2 424 vargje, së cilës mund t'i vendoseshin numrat e këngëve kreshnike, ashtu sikur vendosen para vargjeve të një kënge epike për Bukurinë e Tanushes, Mujin e Halilin, Martesën e Halilit apo këngëve historike për Skënderbeun, Ali Pashë Tepelenën, Gjergj Arianitn, Mic Sokolin, Oso Kukën, Isa Boletinin etj., deri te këngët për Adem Jashari. Paradigmat epike dhe historike të poemës dalin madje prej tipit të vargut, prej përshkrimeve epike të ambienteve, prej përshkrimeve historike të situatave e individëve dhe më në fund prej pasthirrmave tipike që përdoren në fillim të vargjeve dhe në fund të tyre.

Poema është ideuar si një tërësi, një udhëtim brezash drejt një ngjarjeje të cilën shumë studiues janë përpjekur ta saktësojnë përmes dokumenteve të arkivave kombëtare, arkivave të proveniencës ballkanike, madje arkivave angleze e amerikane e, megjithatë, nuk kanë arritur ta thonë të vërtetën e plotë të plojës së madhe mbi atë grup të rinjsh, në të vërtetë mbi brezin më të shëndetshëm të një kombi (nga mosha 16-30 vjeçare), me të cilin Serbia synonte ta eliminonte një brez të tërë të një populli. Poema është konceptuar si një dramë e madhe e një udhëtimi tani tre brezash: të baballarëve të mbetur atje, të bijve, të cilët nuk mund të lirohen ende nga mënyra se si u tradhtuan ata; si dhe të brezit të tretë, të nipave, të cilët kujtesën e ruajnë si një legjendë dhe peng familjar, e për të cilën kanë obligim të mos heshtin, por ta dokumentojnë në mënyrën e tyre dhe ta bëjnë objekt vlerësimi e rindërtimi.

Brezit të tretë i takon edhe autori i kësaj poeme, i cili bën një udhëtim nëpër histori, i udhëhequr nga kujtimet historike të të atit, të cilët bashkërisht udhëtojnë drejt vendit të krimit për të saktësuar sa më bindshëm historikisht dhe për të unifikuar sa më saktë gjeografikisht, jo vetëm shenjen e fundit po gjithë rrugëtimin e tij. Në vargjet e tij përvijohen emrat e pothuajse të gjithë bartësve të së keqes, qofshin ata nga radhët e shqiptarëve të Kosovës a të Shqipërisë, qofshin nga radhët e serbëve, si dhe emrat e vendeve nga Kosova e deri në Tivar nga kanë kaluar të 'mobilizuarit'. Prej leximit të saj mund të përfytyrohet një gjeografi e tërë tragjike e udhëtimit dramatik të tyre: nga Drenica në Prizren, nga Kukësi në Shkodër e nga lumi Buna në Tivar. Prej leximit të saj, në të vërtetë mund të perceptohet një udhëtim sa historik aq edhe dramatik e shpirtëror i këtij brezi tragjik që udhëton nga vendlindja në Tivar.

Shkrimtari Ajet Shala, me këtë formë të artikulimit artistik - poemën Deti i varreve, ka arritur të sendërtojë ëndrrat e disa brezave të popullit shqiptar, për të mos harruar historinë e tyre familjare dhe për ta përkujtuar atë, jo vetëm në kontekstin dokumentar dhe oral, por e dhe krijues.



E jashtëzakonshme

# E rrallë, gruaja humb dëgjimin vetëm për zërin e meshkujve



Një grua në Kinë është diagnostikuar kohët e fundit me një gjendje të rrallë. Ajo arrin të dëgjojë vetëm zërin e femrave dhe jo të meshkujve. Gruaja nga Xiamen, e identifikuar vetëm si Chen, u zgjua në mëngjes dhe nuk arrinte të dëgjonte zërin e të dashurit të saj. Ajo u dërgua në spital e Qianpu duke shpresuar se mjekët do të ishin në gjendje ta ndihmonin atë.

FOTO E DITES



Dy persona shihen duke pastruar borën afër një çatie në Lofer të provincës austriake të Salzburgut /AP/

E rrallë

# Vendos gjarpër në makinën e ish-dashnores, arrestohet 59-vjeçari



Një shtetas italian është arrestuar për përndjekje ndaj dashnores së tij. Ai nuk pranonte ndërprerjen e marrëdhënies dhe për pasojë e kërcënonte vazhdimisht duke i dërguar mesazhe dhe duke e ndjekur vazhdimisht. Madje, burri i kishte vendosur mbi makinë ish-dashnores së tij një gjarpër të ngordhur në formën e zemrës. Pas kësaj, gruaja vendosi që ta denoncojë në polici.

## BARSOLETA E DITËS



**Polici: Ke pi?**
**Shoferi: Jo more çfarë.**
**Polici: Fryj.**
**Shoferi: Ku është torta?**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### “THE GRINCH” 3D,



I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney




Në ora 17:30

### “THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS” 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

### “MORTAL ENGINES” 3D,




Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




Në ora 22:00

### “HUNTER KILLER”,

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
E shkuara dhe marrëdhënia me një ish partner sot do të dalin në sipërfaqe. Nuk do të jetë aspak e lehtë të gjeni justifikime në një debat.



**DEMI**
Jeni pak në ankth sot dhe nuk po e kuptoni nga ju vjen. Dita nuk do të jetë e qetë sepse shumë mendime po ju turbullojnë mendjen.



**BINJAKËT**
Duhet të sqaroni sa më parë një keqkuptim të lindur sepse duke e neglizhuar do të thellohen më shumë mosmarrëveshjet.



**GAFORRJA**
Po mundoheni të ambientoheni me të rejat e fundit që po ju ndodhin. Edhe pse ka shumë rrëmujë rreth e qark jush do të arrini të gjeni oazin tuaj.



**LUANI**
Nuk është se keni ndryshuar mendim lidhur me një person të caktuar, por disa situata të reja ju kanë bërë me dyshues dhe më të vëmendshëm.



**VIRGJERESHA**
Jeni të fokusuar tek familja sot dhe doni t'i plotësoni pjesëtarëve të saj çdo dëshirë që ju kanë shprehur. Kjo gjë ju lumturon pa fund.



**PESHORJA**
Pak lëvizje në jetën në çift nuk bën aspak keq, madje është mënyra për ta shijuar më mirë marrëdhënien. Do të jeni shokë shumë të mirë udhëtimi sot.



**AKREPI**
Sot jeni zgjuar me humor të keq dhe karakteri juaj nuk do të jetë i thjeshtë për t'u duruar përgjatë orëve të ditës.



**SHIGJETARI**
Do të merrni sinjale që fillimi ditës do të jetë i mbushur me ndryshime dhe surpriza. Duhet të filloni që tani të ambientoheni.



**BRICJAPI**
Nuk është se sot planetët do të jenë në rrugën tuaj. Shumë herë do të keni momente tensioni gjatë ditës qe do t`ju duhet t`i përballoni vetëm.



**UJORI**
Edhe pse në momente të caktuara të ditës pozitat tuaja do të lëkunden ndjeshëm, jeni aq të fortë si karakter sa do të arrini të ktheni situatat ne favorin tuaj.



**PESHQIT**
Një ditë jo e mirë dhe pa asnjë lekë të kursyer. Keni shpenzuar kot kohët e fundit për gjëra që nuk i keni pasur të domosdoshme.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | STOKE - SHREWSBURY | 1 | MANSFIELD - CRAWLEY TOWN | 1 | LE HAVRE - VALENCIENNES | 1 |

# Kukaj: Për Dardanën refuzova skuadra të Superligës

Liridon Kukaj kishte rastin të luante përballë Cristiano Ronaldos në një ndeshje miqësore, kurse tash karrierën do ta vazhdojë në klubin e Dardanës. Ish-lojtari i Prishtinës do të jetë edhe ndihmëstrajner i këtij klubi. "Kam arritur marrëveshje për një vit e gjysme me Dardanën dhe këtë vendim e mora pasi fillova të mendoj edhe për të ardhmen si trajner. Në këtë klub trajner është Erdin Hashani, kurse unë do të jem lojtar aktiv dhe ndihmëstrajner. Kisha oferta edhe nga skuadrat e Superligës dhe Ligës së Parë, por edhe zgjodha Dardanën për një sfidë të re", ka thënë Kukaj

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 JANAR - Liridon Kukaj është një nga mbrojtësit më të mirë në futbollin e pasluftës në Kosovë, kurse karrierë ka bërë edhe në futbollin e Shqipërisë dhe në atë të Maqedonisë. Kukaj është në përfundim të karrierës dhe ka vendosur ta djersijë fanellën e skuadrës së Dardanës nga Kamenica. Mbrojtësi në fjalë të dielën për "Epokën e re" ka bërë me dije se ka refuzuar edhe oferta të skuadrave që bëjnë gara në IPKO Superligë për skuadrën që bën gara në Ligën e Dytë. "Kam arritur marrëveshje për një vit e gjysmë me Dardanën dhe këtë vendim e mora pasi fillova të mendoj edhe për të ardhmen si trajner. Në këtë klub trajner është Erdin Hashani, kurse unë do të jem lojtar aktiv dhe ndihmëstrajner. Kisha oferta edhe nga skuadrat e Superligës dhe Ligës së Parë, por edhe zgjodha Dardanën për një sfidë të re", ka thënë Kukaj. "Nuk mund të them se edhe sa vite do të jem futbollist aktiv. Fillimisht të shoh si do të jem me shëndetin në këtë gjysmësezon, pastaj do të vendosi për të ardhmen. Jam i lumtur që jam pjesë e skuadrës së Dardanës e cila ka ambicie të mëdha para vetës", ka shtuar ai.

Pjesë e skuadrës së Dardanës janë edhe dy lojtarë të njohur: Visar Zogiani dhe Erzen Zyberaj. Ish-reprezentuesi i Kosovës foli edhe për ndarjen me skuadrën e Ballkanit në mënyrën jo të duhur. Ai ka treguar se kjo i ka ndodhur për herë të parë në karrierë ani pse kishte rastin të luante në disa skuadra me emër të madh. "Është hera e parë që unë ndahem me një klub në këtë mënyrë. Kam luajtur edhe në shumë klube më të mëdha jashtë si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës, por nuk ka ndodhur që të me suspendojnë ndonjëherë. Kjo më ndodhi për herë të parë



në skuadrën e Ballkanit në mënyrë të papritur dhe pa asnjë arsye. Çka është më e keqja, ky klub nuk ka dalë ende me ndonjë shpjegim rreth suspendimit tim dhe bashkëlojtarëve: Berat Hysenit dhe Qëndrim Sejdiut", ka deklaruar Kukaj, i cili konfirmoi se skuadra nga Suhareka i ka mbetur borxh edhe një pagë.

## Feronikeli dhe Prishtina, favorite për titull

Mbrojtësi që deri tash ishte pjesë e Superligës e ka komentuar edhe garën për titullë të kampiones. Kukaj i ka vlerësuar dy skuadrat e para si favorite kryesore për trofeun e më të mirit në futbollin e Kosovës. "Është një kampionat interesant dhe besoj ashtu do të jetë deri në fund, kurse favorit kryesorë janë Feronikeli dhe Prishtina", ka shtuar Kukaj, i cili ka bërë karrierë në këto skuadra: KEK, Prishtinë, Trepçë '89, Gramozi, Vllaznia dhe Milano Kumanovë.

## SHKURT

### Jashari karrierën e vazhdon te Ballkani

Mbrojtësi Dardan Jashari u largua ditë më parë nga skuadra e Llapit, kurse tash ka vendosur për skuadrën e tij të re. Mbrojtësi me përvojë ka pranuar ofertën e skuadrës së Ballkanit, kurse ka premtuar se do ta japë maksimumin për t'i arritur objektivat e klubit. "Kam arritur marrëveshje që stinorin pranveror të jem pjesë e klubit të Ballkanit nga Theranda. Falënderoj kryesinë, trajnerët dhe bashkëlojtarët për mikpritjen. Premtoj se do ta jap maksimumin tim për këtë klub që të kemi suksese bashkërisht", ka thënë Jashari.

### Përfundon sezoni për Malokun

Ka përfunduar sezoni për portierin Faton Maloku, i cili në këtë sezon ka pasur pak minuta, vetëm dy ndeshje si titullar në kampionat. Dëmtimi që pësoi ish-reprezentuesi i Kosovës pak ditë më parë në fazën përgatitore në Turqi është më i rëndë sesa parashikohej dhe Maloku do të detyrohet t'i nënshtrohet një operacioni në tendinë, ndërhyrje që do ta mbajë jashtë fushave të futbollit për 4 deri në 5 muaj, çfarë do të thotë se ky sezon ka përfunduar përpara. Vendin e tij në skuadër si zëvendësues i Frashërit do ta marrë i riu Jetmir Basha i cili mbron portën e Kukësit B.

### Tifozët "Ujqit": HIB, thuaj po Ferizajt

Tifo grupi ferizajas, "Ujqit", e ka ndërmarrë një iniciativë për shpëtimin e KF Ferizaj, që ndodhet buzë greminës. Këta tifozë po e ftojnë kompaninë "HIB", që ta marrë drejtimin e klubit. "HIB, thuaj po Ferizajt", është motoja e ferizajasve. Kjo kompani ka drejtuar Ferizajn edhe në të kaluarën, duke investuar jo pak, ku bardhekaltrit renditeshin në pjesën e epërme të tabelës.

### Medesi përforcon Dardanën

KF Dardana është duke u përgatitur maksimalisht për sezonin pranveror. Synim i kësaj skuadre është inkuadrimi në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Skuadra nga Kamenica, pas Liridon Kukajt, është përforcuar edhe me futbollistin e Flamurtarit të Prishtinës, Oscar Vicente Mendes. Ky i fundit luan në pozitën e sulmuesit.

## Murray mbyll karrierën pas eliminimit nga "Australian Open"



MELBOURNE, 14 JANAR - Turneu i parë "Grand Slam" i vitit në tenis, "Australian Open", nisi me një surprizë. Andy Murray u eliminua që në raundin e parë të turneut që zhvillohet në Melbourne. Spanjolli Roberto Bautista Agut ishte ai që mundi britanikun, në atë që mund të quhet ndeshja e fundit e karrierës së tij. "Ju falënderoj të gjithëve që erdhët. Kam luajtur këtu për shumë vite. Është një vend i mrekullueshëm për të luajtur tenis. Nëse kjo ishte ndeshja ime e fundit, atëherë u mbyll në mënyrë të mrekullueshme. Dhashë maksimumin tim, por nuk mjaftoi. Kështu që uroj Roberton dhe stafin e tij", ka thënë Murray.

## Levante nuk lejon largimin e Sadikut



TIRANË, 14 JANAR - Armando Sadiku u bë ëndrra e madhe e këtij afati kalimtar për Luganon. Rikthimi nga periudha e dëmtimit dhe mundësitë minimale për aktivizim te Levante i bënë zviceranët që t'i shtonin shpresat për të rikthyer në ekip sulmuesin kuqezi. Mirëpo, së fundmi është një njoftim në prestigjiozen spanjolle "Marca", që bën me dije se sulmuesi nuk largohet. "Në momentin që po rikuperohet plotësisht, Levante duket se e ka hequr nga lista e merkatos. Referuar spanjolles 'Marca', sulmuesi shqiptar nuk do ta lërë Valencian këtë periudhë transferimesh, duke parë edhe që drejtuesit e Levantes duan t'i japin një shans, duke besuar në vlerat e tij", ka shkruar "tio.ch".

# Ndahen stemat e FIFA-s për 10 gjyqtarë

PRISHTINË, 14 JANAR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, në shoqëri të anëtares së KE, Vjollcë Krasniqi, sekretarit të përgjithshëm Eroll Salihu dhe kryetarit të Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, e kanë bërë sot shpërndarjen e stemave të FIFA-s për dy gjyqtarë kryesorë, gjashtë asistentë dhe tre gjyqtarë të futsallit. Me këtë rast, presidenti Ademi ka vlerësuar lart paraqitjet e gjyqtarëve tanë me stemë të FIFA-s dhe ka kërkuar nga ata të vazhdojnë të dëshmojnë nivel të lartë në punën e tyre, qoftë në arenën vendore, qoftë në atë ndërkombëtare. Njëherësh, kryetari i FFK-së ka shprehur besimin se në vitet e ardhshme numri i gjyqtarëve të Kosovës me stemë të FIFA-s do të shënojë rritje, por ka kërkuar nga të gjithë gjyqtarët të punojnë me zell dhe në mënyrë sa më profesionale për t'ia lehtësuar vetes rrugën deri te arritja e stemës së FIFA-s.



**GJYQTARËT ME STEMË TË FIFA-S**

Genc Nuza
Besfort Kosumi
Fatlum Berisha
Bujar Selimaj
Fatmir Sekiraqa
Edmond Zeqiri
Lumturije Muhadri

**FUTSALL**

Besar Beqiri
Besart Ismajli
Ekrem Franca

# Lakersat mposhten nga Clevelandi, Toronto triumfon pas 10 minutave shtesë

LOS ANGELES, 14 JANAR - Lakersat janë mposhtur 101-95 në fushën e vet nga Clevelandi, ekipi që mbyll renditjen në Konferencën e Lindjes, një humbje e papritur dhe e turpshme e ekipit kalifornian. Miqtë dominuan gjatë gjithë kohës në ndeshje, duke pasur një avantazh prej 10 pikësh përgjatë takimit. Të pestë titullarët e Clevelandit realizuan mbi 15 pikë, me Osmanin që ishte shënuesi më i mirë me 20 pikë. Te Lakersat u ndje shumë mungesa e LeBron Jamesit, që qëndroi në stol në sfidën ndaj ish-skuadrës së tij, ende i dëmtuar, ndërkohë që shënuesi më i mirë për kalifornianët ishte Kuzma me 29 pikë. Fitore dramatike për ekipin e Torontos, që iu deshën dy kohë shtesë për ta mposhtur Washingtonin 140-138. Edhe pse kanadezët u shkëputën deri në 25 pikë, në fund rrezikuan ta kumbisnin ndeshjen. Më i miri për kanadezët u dallua Leonardo, autor i 41 pikëve e 11 reboundeve, mbështetur edhe nga Siakami me 24 pikë e 19 rebounde. Ndërsa për Washington nuk mjaftoi "triple double" e Bealit, që e mbylli ndeshjen me 43 pikë, 10 rebounde e 15 asiste. Në krye të renditjes në Perëndim vijon të qëndrojë skuadra e Denverit, që bën detyrën ndaj Portlandit, duke fituar 116-113 (Jokiqi 40 pikë e 10 rebounde).



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| New York - Philadelphia | 105-108 |
| Washington - Toronto | 138-140 |
| Atlanta - Milwaukee | 114-133 |
| Orlando - Houston | 116-109 |
| Dallas - Golden State | 114-119 |
| Denver - Portland | 116-113 |
| Lakers - Cleveland | 95-101 |

## SHKURT

### Ancelotti: Hysaj dëshiron të qëndrojë te Napoli

Trajneri Carlo Ancelotti ka folur rreth së ardhmes së Elseid Hysajt. Trajneri italian ka bërë me dije se futbollisti shqiptar nuk do të largohet nga Napoli. "Çështja 'Hysaj' është menaxhuar shumë mirë. Kemi pasur një takim dhe kemi kuptuar që ai dëshiron të qëndrojë, ndërsa ne e vlerësojmë shumë. Pastaj në një sezon të gjatë mund të kesh ulje-ngritje. Ai dhe menaxheri i tij janë shumë të qetë", ka thënë Ancelotti.

### Solari: Nuk kam asgjë personale me Iscon

Trajneri Santiago Solari ka thënë se lënia e Iscos në bankën rezervë nuk ka të bëjë me asgjë personale kundër tij. Real Madridi fitoi si mysafir 2-1 ndaj Real Betisit dhe futbollisti spanjoll ishte në bankën rezervë sërish, mirëpo nuk u përdor fare në pjesën e dytë si zëvendësues, pavarësisht se mungonin Gareth Bale, Lucas Vazquez, Toni Kroos e Marco Asensio. "Ne luajtëm një ndeshje serioze, ne jemi ata që jemi dhe ne jemi të bashkuar. Nuk kam asgjë personale. Të gjithë lojtarët janë të rëndësishëm. Ne luajmë çdo tri ditë. E ardhmja e tij? Nuk më takon mua të përgjigjem", ka thënë Solari.

### Monaco, e ardhmja e Batshuayit

Michy Batshuayi, që është i huazuar nga Chelsea te Valencia, është afër largimit nga kjo skuadër. 25-vjeçari është në bisedime me Monacon në Ligën 1. Trajneri i Monacos, Tierry Henry, ka folur prej ditësh për mundësinë e afrimit të Batshuayit, për të cilin dyert e skuadrës së tij ishin të hapura. Edhe nga "Mestalla" shihet me sy të mirë arritja e një marrëveshjeje me klubin francez, pasi belgu e pati shumë të vështirë për t'u përshtatur në kampionatin spanjoll.

### Arsenali dëshiron ta shesë në janar, reagon Ozili

Pas shkrimeve të gazetave britanike se Unai Emery dëshiron ta largojë nga skuadra e Arsenalit, Mesut Ozilin, mesfushori gjerman ka reaguar përmes një postimi në rrjetet sociale. Ozili e ka postuar një fotografi të veten duke stërvitur në palestër, me mbishkrimin se çfarëdo që ndodh, puna vazhdon. "Pavarësisht çfarë ndodh, puna e zellshme vazhdon", ka shkruar Ozili, i cili është lënë jashtë skuadrës së "topçinjve" në disa ndeshje deri tani këtë sezon dhe shpesh ka qenë në stol, duke e humbur plotësisht besimin e Emery.

### Bartra: Vinisiusi më shau tri herë nënën

Reali i Madridit siguroi fitoren e parë në kampionat për vitin 2019, duke fituar 2-1 në një fushë të vështirë si ajo e Betisit. Ndeshja ishte e fortë dhe dhuroi gjithçka, madje nuk munguan as thumbimet dhe përplasjet midis lojtarëve. Protagonistët ishin Vinisius i Realit dhe Mark Bartra i ekipit vendës. Ish-katalanasi ka treguar për "Marca" episodin e ndodhur me sulmuesin brazilian, duke pretenduar se është ofenduar nga ai. "Vinisius kalonte më shumë kohë i shtrirë në fushë sesa në këmbë. I thashë që duhet t'u jepte fund simulimeve, por ai më fyeu tri herë, madje më shau me nënë. Ai ka shumë për të mësuar, por nuk mendoj se këto janë sjellje të denja për një lojtar të Realit të Madridit", ka thënë Bartra.

PERLAT sh.p.k

Prishtinë, 14.01.2019

## NJOFTIM

Shoqëria **„Perlat" SH.P.K.**, me nr. të biznesit 70580047 dhe Numër fiskal 600301618 me adresë: rruga „Mbretresha Teutë" Prishtinë, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 10 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në BRE, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Projekti ALPHA POWER me kapacitet të instaluar prej 3 MW , ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

Aplikacioni i shoqërisë „Perlat" SH.P.K., Projekti **ALPHA POWER** me kapacitet të instaluar prej 3 MW, ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, është jashtë caqeve të BRE-ve, të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017, dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 6 paragrafit 7 të Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse, në vendimin për Lëshimin e Autorizimit Preliminar do të specifikohet se procesi për pranim në Skemën Mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, dhe ky aplikacion do të konsiderohet si aplikacion "në pritje" për pranim në Skemën Mbështetëse

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Gazmend Haxholli

SHOQËRI NË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA PERLAT SH.P.K. PRISHTINË

---

JAHA ExtraBETON

Prishtinë, 15.01.2019

## NJOFTIM

Shoqëria **„Jaha Extra Beton" SH.P.K.**, me nr. të biznesit 71244849 dhe Numër fiskal 601582910 me adresë: rruga „Ismail Qemali" nr. 17 Prishtinë, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 10 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në BRE, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Projekti DUKA SONNE 1 me kapacitet të instaluar prej 3 MW , ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

Aplikacioni i shoqërisë „Jaha Extra Beton" SH.P.K., Projekti **DUKA SONNE 1** me kapacitet të instaluar prej 3 MW, ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, është jashtë caqeve të BRE-ve, të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017, dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 6 paragrafit 7 të Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse, në vendimin për Lëshimin e Autorizimit Preliminar do të specifikohet se procesi për pranim në Skemën Mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, dhe ky aplikacion do të konsiderohet si aplikacion "në pritje" për pranim në Skemën Mbështetëse

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

SHOQËRI NË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA Jaha ExtraBETON PRISHTINË

---

JAHA ExtraBETON

Prishtinë, 15.01.2019

## NJOFTIM

Shoqëria **„Jaha Extra Beton" SH.P.K.**, me nr. të biznesit 71244849 dhe Numër fiskal 601582910 me adresë: rruga „Ismail Qemali" nr. 17 Prishtinë, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 10 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në BRE, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Projekti DUKA SONNE 2 me kapacitet të instaluar prej 3 MW , ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

Aplikacioni i shoqërisë „Jaha Extra Beton" SH.P.K., Projekti **DUKA SONNE 2** me kapacitet të instaluar prej 3 MW, ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, është jashtë caqeve të BRE-ve, të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017, dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 6 paragrafit 7 të Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse, në vendimin për Lëshimin e Autorizimit Preliminar do të specifikohet se procesi për pranim në Skemën Mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, dhe ky aplikacion do të konsiderohet si aplikacion "në pritje" për pranim në Skemën Mbështetëse

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

SHOQËRI NË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA Jaha ExtraBETON PRISHTINË

---

EDK sh.p.k

Prishtinë, 14.01.2019

## NJOFTIM

Shoqëria **„EDK" SH.P.K.**, me nr. të biznesit 810023086 dhe Numër fiskal 330355447 me adresë: rruga „Skenderbeu" p.n. Skenderaj, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 10 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në BRE, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Projekti SUNPOWER 1 me kapacitet të instaluar prej 3 MW , ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

Aplikacioni i shoqërisë „EDK" L.L.C., Projekti **SUNPOWER 1** me kapacitet të instaluar prej 3 MW, ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, është jashtë caqeve të BRE-ve, të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017, dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 6 paragrafit 7 të Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse, në vendimin për Lëshimin e Autorizimit Preliminar do të specifikohet se procesi për pranim në Skemën Mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, dhe ky aplikacion do të konsiderohet si aplikacion "në pritje" për pranim në Skemën Mbështetëse

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara "EDK" Gllogoc

EDK sh.p.k

Prishtinë, 14.01.2019

## NJOFTIM

Shoqëria „EDK" SH.P.K., me nr. të biznesit 810023086 dhe Numër fiskal 330355447 me adresë: rruga „Skenderbeu" p.n. Skenderaj, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 10 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në BRE, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Projekti SUNPOWER 2 me kapacitet të instaluar prej 3 MW , ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

Aplikacioni i shoqërisë „EDK" L.L.C., Projekti **SUNPOWER 2** me kapacitet të instaluar prej 3 MW, ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, është jashtë caqeve të BRE-ve, të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017, dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 6 paragrafit 7 të Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse, në vendimin për Lëshimin e Autorizimit Preliminar do të specifikohet se procesi për pranim në Skemën Mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, dhe ky aplikacion do të konsiderohet si aplikacion "në pritje" për pranim në Skemën Mbështetëse

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

EDK Gllogoc

.............................................

EDK sh.p.k

Prishtinë, 14.01.2019

## NJOFTIM

Shoqëria „EDK" SH.P.K., me nr. të biznesit 810023086 dhe Numër fiskal 330355447 me adresë: rruga „Skenderbeu" p.n. Skenderaj, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 10 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në BRE, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Projekti SUNPOWER 3 me kapacitet të instaluar prej 3 MW , ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

Aplikacioni i shoqërisë „EDK" L.L.C., Projekti **SUNPOWER 3** me kapacitet të instaluar prej 3 MW, ZK Sverrkë, Komuna e Pejës, është jashtë caqeve të BRE-ve, të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017, dhe në pajtim me dispozitat ligjore të Nenit 6 paragrafit 7 të Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse, në vendimin për Lëshimin e Autorizimit Preliminar do të specifikohet se procesi për pranim në Skemën Mbështetëse do të pezullohet derisa të lirohen caqet e disponueshme, dhe ky aplikacion do të konsiderohet si aplikacion "në pritje" për pranim në Skemën Mbështetëse

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

EDK Gllogoc

.............................................

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

**Drejtoria për Arsim** / Department of Education

Nr. 636 /2019
Dt: 14.01.2019

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenit 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 10/2018 si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komunale e Arsimit në Skenderaj, shpall:

**Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2018/2019**

| Nr. | Niveli | Pozita | Institucioni | Vendi | Pensionim / Zëvendësim | Nr. i orëve | Nr. i pozitave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | SHMT | Mësimdhënës/e për lëndën Farmaci | "Anton Çetta" | Skenderaj | Zëvendësim – deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë | Normë e plotë | 1 |
| 2 | Shfmu | Mësimdhënës/e për Mësim klasor | "Abedin Rexha" | Turiçec | Zëvendësim – deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë | Normë e plotë | 1 |
| 3 | Shfmu | Mësimdhënës/e për Mësim klasor | "Drenica" | Polac | Zëvendësim – deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë | Normë e plotë | 1 |
| 4 | Shfmu | Mësimdhënës/e për Mësim klasor | "Kuvendi i Drenicës" | Abri e Poshtme | Zëvendësim – deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë | Normë e plotë | 1 |
